# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5597
E martë, 9 tetor 2018
çmimi 0.40 €

## Veseli në Pragë: Dialogu, mënyra e vetme e komunikimit mes popujve

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADNAN ASLLANI FAQE 4-5

# Mospërfshirja e 'Zërit të Kosovës' dhe 'Botës së re', gabim i pafalshëm



**- Mospërfshirja e "Zërit të Kosovës" dhe "Botës së re" në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, gabim i pafalshëm**

Në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, të botuar këto ditë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nuk janë përfshirë gazeta "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re". Ish-kryeredaktori i gazetës "Zëri i Kosovës", Adnan Asllani, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ka theksuar se është gabim i pafalshëm se si dy media, të cilat shquheshin për guximin që në aksionet e para i dolën në mbështetje luftës çlirimtare të UÇK-së, të mos jenë të përfshira në Fjalorin enciklopedik të Kosovës. "Meqenëse edhe një numër i akademikëve aktualë kanë qenë pjesë e strukturave të Lidhjes së Komunistëve në të kaluarën, shtrohet pyetja se a mund të jetë e paqëllimshme mospërfshirja e gazetës 'Zëri i Kosovës' në Fjalorin enciklopedik?", ka thënë Asllani

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

# Thaçi kërkon nga Haradinaj korrigjim të qëndrimit për dialogun



Presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar të hënën nga kryeministri Ramush Haradinaj të jetë më racional dhe i përgjegjshëm në qëndrimet për procesin e dialogut. Ky reagim i Thaçit ka ardhur pas deklaratës së Haradinajt, se "ideja për ndryshimin e kufijve ka vdekur". Presidenti ka thënë se kryeministri Haradinaj duhet të ketë qasje më të mençur në këtë proces pasi, siç ka thënë Thaçi, një kryeministër serioz nuk flet çdo ditë për luftëra dhe tragjedi. Ai i ka bërë thirrje Haradinajt që t'i korrigjojë deklaratat dhe qëndrimet e veta lidhur me procesin e dialogut FAQE 3

## Haradinaj: Kosova s'do të eksportojë pasiguri në BE, por qytetarë të ndershëm

FAQE 7



## AKTUALE

### RRUGA JURIDIKE E KOSOVËS PAS LUFTËS ÇLIRIMTARE F. 11



Shkruan: Jakup KRASNIQI



### KOSOVA NDERON SHKRIMTAREN ELENA KADARE F. 6

### QKUK-ja ME RRUGË TË REJA F. 10

## EKONOMI

### SOT I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT GAZETARIT IBRAHIM REXHEPI F. 8



### INAUGUROHET FAZA E DYTË E IMPIANTIT TË UJIT PËR PIJE NË GJAKOVË F. 9

## KULTURË

### PA VENDLINDJE S'KA LIRI! F. 6

## SPORT

### CHALLANDESI: PRIMARE PARAQITJA E MIRË E KOSOVËS, JO REZULTATET F. 16

### PULLË POSTARE ME IMAZHIN E LEGJENDËS FADIL VOKRRIT F. 17

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Qeveria e Maqedonisë dorëzon ndryshimet kushtetuese në Kuvend

Shkup, 8 tetor - Qeveria në mbledhjen e jashtëzakonshme mori vendim për inicimin e ndryshimeve Kushtetuese në përputhje me Marrëveshjen e Prespës. Në konstatimin e Qeverisë, theksi vendoset në 4 ndryshime thelbësore në nenet ku thuhet Republika e Maqedonisë shtohet "e Veriut", ndryshimin e preambulës dhe përforcimin e vendimeve të KAÇKM-së apo ASNOMIT, përcaktimi i qartë i kufijve të Maqedonisë dhe angazhimi i shtetit për qytetarët e Maqedonisë që jetojnë në diasporë. Nga organi ekzekutiv nuk bëjnë të ditur se sa nene konkretisht do të ndryshohen pasi që kjo do të vërtetohet gjatë procedurës së ndryshimeve kushtetuese. Qeveria nuk konfirmon nëse është siguruar shumica e nevojshme prej 2/3 për miratimin e ndryshimeve. "Këtë do ta shohim pas debatit në Komisionin amë dhe më pas në seancë plenarë kur do të votohet. Për të filluar procedura nevojiten 2/3 e votave. Presim që deputetët në Kuvend do ta përcjellin zërin e qytetarëve, atë që u tha më 30 shtator, këtë që ne sot po e fillojmë, atë që është interes strategjik i Maqedonisë Sot fillon procesi. Dokumenti shkon në Kuvend. Presim që nga nesër do të fillojnë me punë deputetë dhe do të prononcohen", tha Mile Boshnjakovski, zëdhënës i Qeverisë.

# Veseli në Pragë: Dialogu, mënyra e vetme e komunikimit mes popujve

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, në Forum 2000, tha se populli në Kosovë ka ndërtuar për vite me radhë një komunikim të shëndoshë mes vete, duke mos i parë dallimet etnike e fetare si pengesë, por si vlerë e dobishme për ndërtimin e një shteti demokratik, të zhvilluar dhe për një të ardhme më të mirë



Prishtinë, 8 tetor - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur të hënën një fjalim në kuadër të Forum 2000 që po mbahet në Pragë të Republikës së Çekisë. Para të pranishmëve nga vende të ndryshme të botës, të shoqërisë civile dhe të institucioneve, kryeparlamentari Veseli theksoi se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në shumë fusha, po ashtu edhe për avancimin e agjendës evropiane, ka njoftuar zyra për informim e Kuvendit të Kosovës.

Rreth dialogut me Serbinë, fazës finale të tij, kryetari Veseli shprehu vizionin e Kosovës për paqe dhe bashkëpunim për t'u hapur rrugë integrimeve euroatlantike për të dyja vendet. Ai përsëriti se me marrëveshjen finale mes dy vendeve, Kosova do ta ketë vendin e vet në OKB, NATO dhe BE, e Serbia në anën tjetër do ta vazhdonte agjendën e vet evropiane. Ai foli për luftën kundër terrorizmit, duke theksuar përpjekjet dhe rezultatet e treguara nga përkushtimi i institucioneve të Kosovës në këtë drejtim.

Veseli tha se populli në Kosovë ka ndërtuar për vite me radhë një komunikim të shëndoshë mes vete, duke mos i parë dallimet etnike e fetare si pengesë, por si vlerë e dobishme për ndërtimin e një shteti demokratik, të zhvilluar dhe për një të ardhme më të mirë. Gjatë vizitës në Republikën e Çekisë, kryeparlamentari Veseli do të ketë takime të ndryshme, përfshirë kryetarin e Senatit çek, Milan Štech.

# Stoltenbergu: Serbia dhe NATO-ja mund ta tejkalojnë të kaluarën

Beograd, 8 tetor - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të hënën se aleanca mbështet plotësisht procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit e Prishtinës dhe bisedimet ndërmjet tyre janë rruga më e mirë për një zgjidhje, që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve. Ai i bëri këto komente në një paraqitje të përbashkët me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në hapje të stërvitjeve të emergjencave civile në qytetin e Mlladenovcit, rreth 50 kilometra larg Beogradit.



Stërvitjet me emrin "Serbia 2018", organizohen bashkërisht nga NATO-ja, Qendra Evropiane për Bashkërendimin e veprimtarive në raste emergjencash dhe Ministria e Brendshme e Serbisë.

Serbia është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por një nga pak vendet e Ballkanit që nuk janë anëtare të aleancës së NATO-s, e cila është shumë jopopullore ndër serbët që nga fushata e bombardimeve të vitit 1999, që dëboi forcat serbe jashtë Kosovës.

Sekretari Stoltenberg tha se e kupton që NATO-ja është e diskutueshme në Serbi. "Kujtimet e fushatës ajrore të vitit 1999 janë ende të dhimbshme për shumëkënd. Posaçërisht për ata që kanë humbur më të dashurit. Fushata nuk ishte kundër popullit serb. Ishte për t'i mbrojtur civilët në rajonin më të gjerë. Çdo jetë e pafajshme e humbur ishte një tragjedi për të cilën me të vërtetë më vjen keq. Unë u ofroj ngushëllimet e mia familjeve dhe të gjithë atyre që humbën të dashurit në të dy anët e konfliktit. Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë të kaluarën. Por ne mund të lëvizim përtej saj", tha Stoltenbergu.

## Opozita propozon reformën zgjedhore

Tiranë, 8 tetor - Partia Demokratike e opozitës shpalli propozimet e saj për ndryshim të Kodit Zgjedhor, për të larguar nga procesi zgjedhor, siç tha ajo, njerëzit dhe paratë e krimit. Kryetari i saj, Lulzim Basha, tha se platforma e opozitës synon çlirimin e zgjedhjeve nga dhuna, blerjet e votave dhe kërcënimet. Shumica, nga ana e saj ka shprehur edhe ajo pikëpamjet e veta për depolitizim të komisioneve zgjedhore.

Partia Demokratike paraqiti tw hwnwn një platformë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, me propozime që synojnë të shmangin shitblerjen e votës dhe kapjen e procesit zgjedhor nga struktura kriminale. Kryetari i saj, Lulzim Basha tha se ecuria dhe rezultatet e zgjedhjeve në Shqipëri diktohen me dhunë nga banda kriminale të lidhur me partinë socialiste, ndaj amendamentet e kodit zgjedhor duhet ta çlirojnë procesin zgjedhor nga krimi dhe paratë e tij. "Platforma e opozitës përmban 4 pika kryesore: 1. Dekriminalizimi i procesit zgjedhor-vetting i politikës-pastrimi i Policisë së Shtetit nga lidhjet me krimin 2. Sistem masash kundër shitblerjes së votës, e cila është evidentuar si problemi kryesor në raportin e OSBE/ODIHR për vitin 2017. Shitblerja e votës jo vetëm do të konsiderohet korrupsion zgjedhor që trajtohet nga SPAK, Prokuroria e Posaçme



Antikorrupsion dhe Byroja Kombëtare e Hetimit 3. Financimi i partive dhe fushatës, 4. Përdorimi i teknologjive në votim, Identifikimi biometrik, votimi dhe numërimi elektronik", tha Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie

# Thaçi kërkon nga Haradinaj korrigjim të qëndrimit për dialogun



Presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar të hënën nga kryeministri Ramush Haradinaj të jetë më racional dhe i përgjegjshëm në qëndrimet për procesin e dialogut. Ky reagim i Thaçit ka ardhur pas deklaratës së Haradinajt, se "ideja për ndryshimin e kufijve ka vdekur". Presidenti ka thënë se kryeministri Haradinaj duhet të ketë qasje më të mençur në këtë proces pasi, siç ka thënë Thaçi, një kryeministër serioz nuk flet çdo ditë për luftëra dhe tragjedi. Ai i ka bërë thirrje Haradinajt që t'i korrigjojë deklaratat dhe qëndrimet e veta lidhur me procesin e dialogut

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 TETOR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të hënën se procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk ka vdekur, por është në një fazë të rëndësishme. Duke i komentuar deklarimet e kryeministrit Haradinaj, i cili ka thënë se tashmë ka vdekur ideja për korrigjimin e kufirit, Thaçi ka thënë se kjo tregon se Haradinaj ose është në humor të mirë ose ndihet tepër komod në karrigen e vet. Sipas Thaçit, një kryeministër serioz nuk flet çdo ditë për luftëra dhe tragjedi, por zhvillon prioritetet dhe angazhimet për reforma.

Presidenti Thaçi ka kërkuar nga kryeministri një qasje më të mençur dhe më të shkathët në procesin e dialogut. "Dialogu nuk ka vdekur, përkundrazi është në një fazë të rëndësishme. Është deklaratë interesante nga ana e kryeministrit dhe kjo tregon se (ai) ose është në humor të mirë ose ndihet tepër komod në karrigen e vet. Kam pritur nga kryeministri që të jetë më racional dhe i përgjegjshëm në deklaratat për qëndrimet e veta lidhur me dialogun. Një kryeministër serioz nuk flet çdo ditë për luftëra dhe tragjedi, por zhvillon prioritetet dhe angazhimet për reforma. Nuk jam fare i shqetësuar për deklarata populiste apo elektorale pa asnjë përmbajtje sepse, tekefundit, do ta luaj rolin tim udhëheqës në bazë të mandatit tim kushtetues dhe ligjor të obligimeve të mia në procesin e dialogut dhe në asnjë rrethanë nuk do t'i ushtroj ato kompetenca që nuk më takojnë", ka thënë Thaçi, duke shtuar se ai është duke i udhëhequr negociatat në kuadër të dialogut dhe jo kryeministri. "Pres dhe kërkoj nga të gjithë, duke përfshirë edhe kryeministrin, një qasje shumë më të mençur, më të shkathët në këtë proces dhe në përputhje me interesin tonë shtetëror", ka deklaruar Thaçi në një konferencë me gazetarë.

Presidenti Thaçi ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj që t'i korrigjojë deklaratat dhe qëndrimet e veta lidhur me procesin e dialogut. Madje ai e ka kërcënuar me zgjedhje të reja kryeministrin në rast se nuk i korrigjon deklaratat. "Jam i sigurt se kryeministri mund dhe ka nevojë t'i korrigjojë deklaratat dhe qëndrimet e veta lidhur me procesin e dialogut. Pa dialog nuk ka të ardhme euroatlantike për Kosovën, as për NATO-n, as për BE-në dhe as njohje nga Serbia. Sepse, tekefundit, të gjithë e dimë se pozitat tona nuk janë të përhershme. Kryeministrat dhe presidentët mund të ndërrohen, shkojnë e vijnë të tjerë siç janë ndërruar edhe më herët. Sidomos mund të ndërrohen shpejt ata në rast se nuk korrigjohen. Përtej këtyre deklaratave populiste dhe aspak racionale institucionet e Republikës së Kosovës dhe bartësit e tyre duhet të jenë shumë seriozë dhe të punojnë për harmonizimin e qëndrimeve shtetërore në këtë proces të vështirë", është shprehur Thaçi, duke shtuar se është koha që njerëzit të rikorrigjohen dhe ta mbështesin idenë e përfshirjes së Luginës së Preshevës me Kosovën. "Sa i përket ngushëllimit për korrigjim, ky ngushëllim mund të shkojë për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, por mund të jetë personal. Përndryshe, shteti i Kosovës do të punojë deri në fund për kryerjen e angazhimeve që kam marrë për përfshirjen e Luginës së Preshevës në proces dhe bashkëngjitje me Kosovën, që besoj se do të ndodhë. Është koha që njerëzit të rikorrigjohen dhe ta mbështesin idenë e përfshirjes së Luginës së Preshevës me Kosovën sepse kryeministrat dhe presidentët shkojnë e vijnë, por askush nuk mund ta ngushëllojë Preshevën për mbetje në Serbi. Presheva mund t'i bashkohet Kosovës nëse institucionet veprojnë në mënyrë unike dhe nuk bëjnë politika populiste", ka theksuar Thaçi. Ai ka thënë se marrëveshja Kosovë - Serbi është e domosdoshme dhe nëpërmjet saj Kosova fiton njohjen reciproke nga Serbia, njohjen nga pesë vendet e BE-së dhe anëtarësimin në OKB. Thaçi ka bërë me dije se do të respektojë çdo rezolutë të partive politike në Kuvend që respekton Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Presidenti ka folur edhe për liberalizimin e vizave duke thënë se këtë proces e dëmton kërcënimi ndaj organeve të drejtësisë dhe mosvazhdimi i zbatimit të reformave demokratike. Ai ka bërë me dije se sundimi i ligjit ka qenë dhe do të mbetet ndër prioritetet tona si institucione të vendit. "Kjo ka një rëndësi të veçantë dhe imediate për çështjen e liberalizimit të vizave, por edhe aspiratat afatgjata për stabilitet të qëndrueshëm në vendin tonë", ka deklaruar Thaçi, duke shprehur optimizëm se deri në fund të vitit qytetarëve të Kosovës do t'u hiqen vizat.

## Keqpërdoruesit e listave të veteranëve duhet të ndiqen nga drejtësia

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se listat e veteranëve të UÇK-së duhet të hetohen deri në fund. Në një konferencë për media, pas një takimi me udhëheqësit e organeve të drejtësisë, presidenti ka thënë se të gjithë ata që kanë bërë keqpërdorime duhet të ndiqen penalisht. "Vëmendje të veçantë në këtë takim i është kushtuar çështjes së veteranëve. Është pikë në të cilën të gjithë tanimë pajtohemi se keqpërdorimet me listat e veteranëve duhet të hetohen deri në fund. Dhe të gjithë ata që kanë bërë keqpërdorime do të ndiqen nga drejtësia. Duhet të mbrojmë rendin e ligjin, duhet ta mbrojmë shtetin, por duhet ta mbrojmë edhe emrin e UÇK-së nga keqpërdoruesit", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se nuk ka pasur më shumë së 15 mijë veteranë të uniformuar dhe me armë në dorë.

Flet për "Epokën e re" ish-kryeredaktori i gazetës "Zëri i Kosovës", Adnan Asllani

# Mospërfshirja e 'Zërit të Kosovës' d



## - Mospërfshirja e "Zërit të Kosovës" dhe "Botës së re" në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, gabim i pafalshëm

Në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, të botuar këto ditë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nuk janë përfshirë gazeta "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re". Ish-kryeredaktori i gazetës "Zëri i Kosovës", Adnan Asllani, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ka theksuar se është gabim i pafalshëm se si dy media të cilat shquheshin për guximin që në aksionet e para i dolën në mbështetje luftës çlirimtare të UÇK-së, të mos jenë të përfshira në Fjalorin enciklopedik të Kosovës. "Meqenëse edhe një numër i akademikëve aktualë kanë qenë pjesë e strukturave të Lidhjes së Komunistëve në të kaluarën, shtrohet pyetja se a mund të jetë e paqëllimshme mospërfshirja e gazetës 'Zëri i Kosovës' në Fjalorin enciklopedik?", ka thënë Asllani

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 8 TETOR - Në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, të botuar këto ditë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nuk janë përfshirë "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re", që shquheshin për guximin që nga aksionet e para kur dolën në mbështetje të luftës çlirimtare të UÇK-së. Në Fjalorin enciklopedik të Kosovës nuk janë përfshirë as "Epoka e re" dhe "Demokracia autentike" e cila drejtohej nga Ukshin Hoti.

Ish-kryeredaktori i gazetës "Zëri i Kosovës", Adnan Asllani, emri i të cilit është përfshirë në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, por jo edhe gazeta "Zëri i Kosovës", ka thënë se mospërfshirja e "Zërit të Kosovës" dhe "Botës së re" në Fjalorin enciklopedik është gabim i pafalshëm. "Mospërfshirja e këtyre gazetave, që kanë pasur rol vendimtar për formimin e opinionit publik, në rrethana të caktuara kohore, më duket gabim i pafalshëm. Uroj që kjo gjë të ketë ndodhur nga pakujdesia por, meqë fjala është për një botim nga Akademia e Shkencave, do të duhej të kishte vëmendje më të madhe rreth lëshimeve të tilla kjo për hir të korrektësisë, por edhe si një shkëputje nga njëmendësia e kaluar moniste e diktatoriale", ka thënë Asllani në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re".

Ai ka theksuar se në gazetën "Zëri i Kosovës" nuk thuhej asgjë tjetër pos së vërtetës për shtypjen, diskriminimin e nevojën e çlirimit të kombit shqiptar nga zgjedha pushtuese serbo-jugosllave. "Janë me mijëra shkrime, intervista, lajme e fotografi përmes të cilave ajo ka prezantuar realitetin e hidhur në Kosovë e në trojet e tjera shqiptare nën pushtim", ka thënë Asllani. Ai ka bërë me dije se në gazeta "Zëri i Kosovës" kishte bashkëpunëtorë edhe emra të spikatur të gazetarisë, publicistikës, letërsisë etj. "Siç janë Jusuf Gërvalla, Ukshin Hoti, Shaban Sinani, Gazmend Shpuza, Ramiz Kelmendi, Rexhep Qosja, Dritëro Agolli, Ali Podrimja etj", ka treguar Asllani. Po ashtu, ai ka folur edhe për rolin dhe bashkëpunimin që kanë luajtur gazeta "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re".

Ai ka treguar se "Bota e re", përveçse ishte zëri i studentëve të Prishtinës, gjatë luftës në Kosovë kishte edhe një rol tjetër. "Në vitin 1998 gazeta 'Zëri i Kosovës' dhe gazeta 'Bota e re' kanë arritur një marrëveshje për të dalë me materiale të përbashkëta. Kështu, 'Zëri i Kosovës', në pamundësi të dilte me emrin e vet, gjatë kohës së luftës në Kosovë botohej me emrin 'Bota e re'. Ndonëse me emër tjetër, gjithçka që botohej në gazetën 'Zëri i Kosovës' e gjeje brenda gazetës së studentëve 'Bota e re' dhe anasjelltas. Pra, mundësinë e botimit në Kosovë, që deri atëherë nuk e kishte 'Zëri i Kosovës', ia mundësi gazeta 'Bota e re'", ka thënë Asllani.

**"Epoka e re":** *Në Fjalorin enciklopedik të Kosovës, të botuar këto ditë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, është përfshirë edhe emri juaj si ish-kryeredaktor i "Zërit të Kosovës", por jo edhe "Zëri i Kosovës". Komenti juaj, ju lutem!*

**Adnan Asllani:** Gazeta "Zëri i Kosovës" është themeluar më 1981 nga Jusuf Gërvalla me bashkëveprimtarët e tij. Që nga themelimi ajo asnjëherë nuk e ka ndalur botimin, duke dalë fillimisht e përmuajshme, pastaj më vonë e përdyjavshme, dikur javore e gjatë luftës në Kosovë, është botuar e përditshme. Gazeta botohej në shtetet perëndimore dhe gjendej në të gjitha pikat e shitjes nëpër kioske etj. Kurse në trojet shqiptare nën pushtim, bartej dorë me dorë në formë të fshehtë, pasi ishte e ndaluar dhe mund të dënoheshe me burg për posedimin ose leximin e saj. Vlen të theksohet se kryeredaktorët e pjesëtarët e tjerë të redaksisë ishin të gjithë përndjekur politikë. Në atë gazetë nuk thuhej asgjë tjetër, pos së vërtetës për shtypjen, diskriminimin dhe nevojën e çlirimit të kombit shqiptar nga zgjedha pushtuese serbo-jugosllave.

Janë me mijëra shkrime, intervista, lajme e fotografi përmes të cilave ajo ka prezantuar realitetin e hidhur në Kosovë e në trojet e tjera shqiptare nën pushtim. Ajo ishte gazeta që kishte bashkëpunëtorë dhe emra të spikatur të gazetarisë, publicistikës, letërsisë etj., siç janë Jusuf Gërvalla, Ukshin Hoti, Shaban Sinani, Gazmend Shpuza, Ramiz Kelmendi, Rexhep Qosja, Dritëro Agolli, Ali Podrimja etj. "Zëri i Kosovës" është gazeta e vetme shqipe e cila ka pasur guximin, që në aksionet e para, t'i dalë në

# he 'Botës së re', gabim i pafalshëm



mbështetje luftës çlirimtare të UÇK-së.
Si gazetë, përveç nga pushtuesit serbo-jugosllavë, ajo nuk shihej me sy të mirë edhe nga një pjesë e shqiptarëve të cilët kishin ndërgjegjen e vrarë për dëmet që i kishin shkaktuar popullit të tyre, duke botuar artikuj promovues për Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, duke i thurë lavde nga më të ndryshmet shokut të tyre, Tito etj., edhe duke dënuar demonstratat e vitit 1981 e duke dënuar çdo organizim patriotik shqiptar. Me një fjalë, një pjesë e shqiptarëve, fatkeqësisht edhe me përgatitje të lartë shkollore, ishin bërë vegla të pushtetit për ta dënuar rininë e për t'i dënuar të drejtat legjitime të popullit të tyre.
Pas ardhjes së pluralizmit, njerëz të tillë ndërruan petkun. Ata që në emër të Lidhjes së Komunistëve kishin dënuar demonstratat dhe rininë shqiptare, tani dilnin në përkrahje formale të atyre ngjarjeve, por që të burgosurit politikë dhe gjithë organizimin klandestin i etiketonin si të kuq, të papërshtatshëm, pa sens politik etj. Madje një pjesë e tyre, fatkeqësisht, përhapën mjegull edhe për UÇK-në si e dyshimtë, pjesëtarët e saj i quajti njerëz me maska, vegla të Beogradit e gjëra të tjera të pavërteta. Meqenëse edhe një numër i akademikëve aktualë kanë qenë pjesë e strukturave të Lidhjes së Komunistëve në të kaluarën, shtrohet pyetja se a mund të jetë e paqëllimshme mospërfshirja e gazetës 'Zëri i Kosovës' në fjalorin enciklopedik?
Do të ndihesha i trishtuar sikur kjo pjesë e 'intelektualëve' të kishte ndikuar në heqjen nga enciklopedia të gazetës 'Zëri i Kosovës' dhe kështu të vazhdonte shërbimin me apo pa vetëdije të mbjelljes së të pavërtetës tek gjeneratat e reja. Në fakt, edhe çdo arsyetim tjetër do të më dukej më shumë se banal!

**"Epoka e re":** *Krahas "Zërit të Kosovës", mungojnë të gjitha gazetat e tjera të Lëvizjes Politike Kombëtare të periudhës 1980-1990. Si të shpjegohet kjo mospërfshirje nga ana e redaksisë së Fjalorit enciklopedik?*
**Adnan Asllani:** Prandaj, fjala nuk është vetëm për gazetat si burime informacioni. Mua më duket se fjala është më shumë për vijën politike që kanë ndjekur ato gazeta e me të cilat nuk janë pajtuar pikërisht ata që përmenda më herët. Ata jo që nuk janë pajtuar me vijën politike, por ata ishin në taborë krejt të kundërt, fatkeqësisht. Derisa gazetat që botoheshin kryesisht jashtë vendit, e përvijoheshin fshehurazi në Kosovë, ndiqnin një vijë antipushtuese, një pjesë e shqiptarëve e kishin mirë me pushtetet dhe nuk i konsideronin pushtues. Më ka rënë të dëgjoj nga ata, e të lexoj ndonjë shkrim të tyre përmes të cilave, kur i referohen pushtimit të Kosovës, ata e kanë mendjen tek viti 1989, atëherë kur asaj iu suprimua edhe ajo autonomi, sado e cunguar që ishte. Gjithçka tjetër për këtë kategori dukej e tepruar, e panevojshme, madje e lidhur me shërbime të huaja. Thënë shkurt, ishin dhe janë për keqardhje!

**"Epoka e re":** *Meqenëse jemi te mospërfshirja, në Fjalorin enciklopedik mungon edhe "Demokracia autentike" e Ukshin Hotit si dhe gazeta studentore "Bota e re", me të cilën ju, si kryeredaktor i "Zërit të Kosovës", gjatë luftës keni pasur afri dhe bashkëpunim të veçantë. Ç'është ky përjashtim i gazetave kryesore mbështetëse dhe zëdhënëse të luftës së UÇK-së?*
**Adnan Asllani:** "Demokracia autentike" kishte një politikë redaktuese të përafërt me gazetën "Zëri i Kosovës". Edhe nga vetë emri i saj, e kuptueshme se ajo do t'i denonconte shtrembërimet që bëheshin në shoqërinë tonë. Aq më tepër që drejtues i asaj gazete ishte intelektuali i pakompromis, i dënuari dhe i përndjekuri politik, filozofi dhe ideologu Ukshin Hoti.
"Bota e re", përveçse ishte zëri i studentëve të Prishtinës, gjatë luftës në Kosovë kishte edhe një rol tjetër. Në vitin 1998 gazeta "Zëri i Kosovës" dhe gazeta "Bota e re" kanë arritur një marrëveshje për të dalë me materiale të përbashkëta. Kështu, "Zëri i Kosovës", në pamundësi të dilte me emrin e vet, gjatë kohës së luftës në Kosovë botohej me emrin "Bota e re". Ndonëse me emër tjetër, gjithçka që botohej në gazetën "Zëri i Kosovës" e gjeje brenda gazetës së studentëve "Bota e re" dhe anasjelltas. Pra, mundësinë e botimit në Kosovë, që deri atëherë nuk e kishte "Zëri i Kosovës", ia mundësoi gazeta "Bota e re".
Mospërfshirja e këtyre gazetave, që kanë pasur një rol vendimtar në formimin e opinionit publik, në rrethana të caktuara kohore, më duket një gabim i pafalshëm. Uroj që kjo gjë të ketë ndodhur nga pakujdesia por, meqë fjala është për një botim nga Akademia e Shkencave, do të duhej të kishte vëmendje më të madhe rreth lëshimeve të tilla kjo për hir të korrektësisë, por edhe si një shkëputje nga njëmendësia e kaluar moniste e diktatoriale.

# Sa kushton transformimi i FSK-së?

**Prishtinë, 8 tetor** - Transformimi dhe ngritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) pritet t'i kushtojë buxhetit të Kosovës nga 55 milionë euro në vit, sa është tani, në afër 100 milionë euro në vit, diku pas pesë apo gjashtë vjetësh.
Nga 1.8 miliard euro të buxhetit të Kosovës për vitin 2018, për FSK-në, këtë vit janë ndarë 55 milionë euro. Por, për transformimin e FSK-së është planifikuar që buxheti për çdo vit të rritet me nga 5 deri në 6 milionë euro. Sidoqoftë, kostoja e gjithë procesit të transformimit të FSK-së nuk është bërë ende e ditur nga autoritetet përgjegjëse pasi që, siç thuhet, ende nuk ka ndonjë përllogaritje të saktë.
Pavarësisht prej kostos, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës thonë se ka bazë financiare për të ecur tutje me transformimin e FSK-së. Sipas tyre, brenda dhjetë vjetësh, sa është paraparë të marrë kohë ky proces, nga buxheti i Kosovës do të arrihet të sigurohen mjetet financiare.
Transformimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës në një Forcë të Armatosur, që nënkupton kalimin nga një forcë të angazhimeve e veprimeve për emergjenca në një forcë me karakter të plotë ushtarak, është paraparë pas një vlerësimi të sektorit të sigurisë në vend dhe rekomandimeve që NATO ka dhënë për përmbushjen e kapaciteteve operacionale.
Këshilltari për ekonomi në Qeverinë e Kosovës, Haki Shatri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se buxhetet e ardhshme të cilat do të aprovohen pas miratimit të pakos ligjore që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës do të përcillen me mjete financiare. "Çdo obligim për formimin e Ushtrisë konsiderohet nga buxheti pas miratimit të ligjit në këtë rast për ushtrinë e Kosovës. Ne jemi të vetëdijshëm që ajo ka kosto, ndërrimi i emrit nuk nënkupton asgjë nëse nuk përcillet me mjete materiale që e mundësojnë më pas misionin që ka ushtria. Jemi të sigurt që e kemi bazën dhe do të mbështesim ashtu siç është kërkesa dhe nevoja", ka thënë Shatri. Ai thotë se janë bërë disa vlerësime për koston, por që nuk janë shifra konkrete dhe se nuk janë për opinion. "Sipas planeve, transformimi duhet të ndodhë në një periudhë dhjetëvjeçare dhe kjo mundëson edhe përshtatjen e nevojave buxhetore", ka thënë Shatri.
Në Kuvendin e Kosovës është në shqyrtim pakoja e projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
Kjo pako përfshin projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, projektligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes.
Të tri projektligjet kanë edhe implikime buxhetore.
Ibrahim Shala, drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se është paparë të ketë ngritje graduale të buxhetit të FSK-së. "Ne jemi duke folur për një tranzicion që është në vazhdim, flitet për ndërrim të misionit e për ta ndërruar misionin nuk do të thotë të ketë mjete financiare të shumta sesa kemi aktualisht, sepse pastaj, pas ndërrimit të misionit, çdo ushtri, edhe FSK-ja do të zhvillohet në përputhje me fuqinë dhe buxhetin e shtetit që kemi", ka deklaruar Shala.
Ai ka theksuar se sa i përket bazës buxhetore për transformim të FSK-së është planifikuar që buxheti i ndarë nga Qeveria për FSK-në për çdo vit të shtohet me nga 5 deri në 6 milionë euro.



## Pakoja ligjore e reformës shtetërore, edhe një hap më afër miratimit

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka aprovuar të hënën pakon ligjore të reformës së administratës publike, përkatësisht Projektligjin për organizim dhe funksionim të administratës së shtetit, Projektligjin për zyrtarët publikë dhe Projektligjin për pagat.
Pas aprovimit të kësaj pakoje, Koordinatori për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë se këto tri ligje bazike janë esenciale për rregullimin dhe qartësimin e organizimit të institucioneve të shtetit si dhe barazisë në pagë.
Tahiri ka vlerësuar se përmbyllja e këtij procesi do ta qartësojë përfundimisht funksionimin e administratës shtetërore dhe do ta kthejë atë në bazën themelore përgjatë rrugëtimit tonë drejt integrimit evropian. "Është tejet e rëndësishme që në proces të këtë debat të mirëfilltë dhe përmbajtjesor duke vendosur fokusin në adresimin e gjetjeve të evidentuara dhe mangësive në mënyrë që ky proces të shtyhet përpara. Në hapin e radhës, leximin e parë, presim të kemi vullnet të fortë dhe konsensus ndërpartiak për ta përmbyllur një proces i cili siguron organizim efikas të funksionimit të shtetit, po ashtu për të kaluar këtë ligj në Kuvend", ka thënë Tahiri.



# Kosova nderon shkrimtaren Elena Kadare





**Shkrimtarja Elena Kadare është dekoruar të hënën nga presidenti Hashim Thaçi me Medaljen Presidenciale të Meritave, kurse kryeministri Ramush Haradinaj ia ka dhuruar asaj "Hartën e Artë të Kosovës"**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 TETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën e ka dekoruar shkrimtaren e njohur Elena Kadare me Medaljen Presidenciale të Meritave. Presidenti Thaçi ka thënë se në kujtimet dhe publicistikën e shkrimtares Elena Kadare vend të veçantë zë edhe dashuria për Kosovën. "E dekorova shkrimtaren e njohur Elena Kadare për kontributin e saj autentik për pasurimin e letërsisë shqipe. Tek Elena Kadare, në kujtimet dhe publicistikën e saj, vend të veçantë zë edhe dashuria për Kosovën", u shpreh presidenti Thaçi.
Ndërsa shkrimtarja Elena Kadare e ka falënderuar presidentin Thaçi për dekoratën e ndarë dhe ka evokuar kujtime nga vizitat e saj të mëhershme. "Sa herë që vij në Kosovë vërej përparim dhe i gëzohem çdo të arriture të Kosovës", ka thënë shkrimtarja Kadare.
Presidenti Thaçi ka theksuar se fryma oksidentale e familjes Kadare është një vlerë e veçantë e kulturës sonë. Po ashtu, edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim shkrimtaren e njohur Elena Kadare. Haradinaj në këtë takim ia ka dhuruar Elena Kadaresë "Hartën e Artë të Kosovës", si mirënjohje për krijimtarinë e saj letrare, ruajtjen e vlerave tona dhe përhapjen e tyre në botë. "Shqiptarët janë me fat që kanë Elena dhe Ismail Kadarenë! Bashkëshortët Kadare ishin zëri ynë kudo në botë. Ata u ndihmuan popujve të tjerë që t'i njihnin shqiptarët dhe të drejtën e tyre. Shquhen për ndjenjën e jashtëzakonshme për Kosovën dhe këtë e manifestuan kurdoherë me dashuri të madhe. Elena Kadare na ka dhuruar rrëfimet më origjinale, për botën, për shqiptarët dhe për vetën e saj. Me një ndjenjë të veçantë pata nderin t'ia dhuroj Elenës 'Hartën e Artë të Kosovës' si mirënjohje për krijimtarinë e saj letrare, ruajtjen e vlerave tona dhe përhapjen e tyre në botë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Nitaj kërkon konservimin dhe mbrojtjen e kullave të Kompleksit Memorial në Prekaz

PREKAZ, 8 TETOR (ER) - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Muharrem Nitaj, i shoqëruar edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit Parlamentar për Bujqësi e Planifikim, ka vizituar Kompleksin Memorial në Prekaz. Ai ka thënë se kullat e Jasharëve duhet të ruhen e të mbahen në këmbë për shekujt që vijnë, e jo për 20-30 vjet. Sipas Nitajt, duke pasur parasysh gjendjen aktuale, ato nuk mund të qëndrojnë gjatë në këmbë. Ai ka shtuar se Prekazi, Gllogjani, Marina, Krusha e dhjetëra vende të lavdisë sonë, janë Meka dhe Jerusalemi shqiptar. "Kullat e Kompleksit Memorial në Prekaz duhet të ruhen e të mbahen në këmbë për shekujt që vijnë, e jo për 20-30 vjet. Në gjendjen në të cilën, bashkë me kolegë deputetë, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Bujqësi e Planifikim, i pamë sot, ato nuk mund të qëndrojnë gjatë në këmbë. Prandaj shteti duhet të ndërhyjë që ta bëjë konservimin e kullave! Puna e madhe që është bërë në Kompleksin Adem Jashari nuk quhet e kryer pa konservimin dhe mbrojtjen objekteve, që janë dëshmi e një kohe dhe e një historie. Prekazi, Gllogjani, Marina, Krusha e dhjetëra vende të lavdisë sonë, janë Meka dhe Jerusalemi shqiptar", ka deklaruar Nitaj.





Është mbajtur takimi i radhës i nivelit të lartë të sundimit të rendit dhe ligjit

# Haradinaj: Kosova s'do të eksportojë pasiguri në BE, por qytetarë të ndershëm

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të hënën se Kosova nuk do të eksportojë kriminalitet dhe pasiguri në BE. Në takimin e radhës të nivelit të lartë të sundimit të rendit dhe ligjit, kryeministri Haradinaj ka thënë se nga Kosova për në BE do të shkojnë vetëm qytetarë të ndershëm, turistë, studentë, sipërmarrës dhe njerëz që do të udhëtojnë në BE për nevoja pune

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se nga Kosova në BE do të udhëtojnë qytetarë të ndershëm, studentë dhe sipërmarrësit. Në takimin e radhës të nivelit të lartë të sundimit të rendit dhe ligjit, ku është diskutuar për rastet e shënjestruara, që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimin ilegal, kreu i Qeverisë ka thënë se Kosova nuk do të eksportojë pasiguri në BE, por qytetarë të ndershëm.

Kryeministri Haradinaj ka treguar se dukuria e migrimit ilegal ka shënuar rënie, duke vlerësuar angazhimin e të gjitha institucioneve të Kosovës për ndaljen e kësaj dukurie ilegale të qytetarëve të Kosovës për në vendet e BE-së. "Ne kemi bërë punë të mirë për ndaljen e fluksit potencial. Shifrat e azilkërkuesve kanë rënë në mënyrë drastike. Nga viti 2015 deri më sot kemi rënie të azilkërkuesve mbi 95 për qind, prej 67 mijë në 2015-n, kemi rënie në 2 800 në vitin 2018. Por ne duhet të punojmë më shumë. Qytetarët tanë duhet ta dinë se e ardhmja e tyre është në Kosovë, me Kosovën në BE. Kosova nuk do të eksportojë kriminalitet dhe pasiguri në BE, por qytetarë të ndershëm, turistë, studentë, sipërmarrës dhe njerëz që do të udhëtojnë në BE për nevoja pune", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj ka deklaruar se rastet e shënjestruara dhe migrimi ilegal janë dy tema me rëndësi për vendin, sidomos tani kur Kosova është në fazën finale, pra në vendimin përfundimtar për liberalizimin e vizave. "Çështja e migrimit është çështje kryesore ku Bashkimi Evropian dëshiron të sigurohet se nga Kosova nuk do të ketë migrim drejt shteteve të BE-së", është shprehur ai.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në këtë takim ka deklaruar se rënia e numrit të azilkërkuesve nga Kosova në vendet anëtare të Bashkimit Evropian vjen si rezultat i kontrollit efikas të kufijve, ndjekjes ndaj kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimit rajonal. Sipas tij, arritje kanë shënuar edhe politikat e reja të integrimit të personave të riatdhesuar në Kosovë, duke shtuar se Kosova ka strategjinë e re të integrimit të personave të riatdhesuar dhe nga viti 2015 kanë përfituar më se 15 mijë persona nga skemat e riintegrimit.

Në këtë takim është biseduar edhe për rastet e shënjestruara, për të cilat është thënë se janë shënuar rezultate, por kërkohet që edhe më tutje të ketë një dinamikë të shtuar dhe të shënohen rezultate pozitive në zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara dhe të shënjestruara.

Përfaqësuesit institucionalë kanë shprehur gatishmërinë që rastet e shënjestruara të kenë prioritet dhe të zgjidhen brenda afateve të parapara. Të arriturat institucionale në këtë takim janë paraqitur edhe nga kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, dhe përfaqësues të tjerë institucionalë.

Institucionet e Kosovës kanë marrë mbështetjen dhe inkurajimin për ta vazhduar punën edhe nga e ngarkuara me Punë në Misionin e Shteteve të Bashkuara në Republikën e Kosovës, Colleen Hyland, shefja e Misionit të BE-së, Nataliya Apostolova dhe shefja e EULEX-it, Alexandra Papadopoulos, derisa pjesë e takimit ishte edhe shefja e Misionit të USAID-it, Lisa Magno.

## Komisioni parlamentar dhe ministrja Hoxha bashkërendojnë aktivitetet për vizat

Anëtarët e Komisionit për Integrime Evropiane të hënën kanë pritur në takim pune ministren e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në procesin e lobimit për liberalizimit e vizave për Kosovën. Duke pasur parasysh se jemi në fazën finale të vendimmarrjes së institucioneve të BE-së, si dhe duke pasur parasysh rolin e Komisionit për Integrime Evropiane në procesin e liberalizimit të vizave, anëtarët e këtij komisioni kanë shprehur vullnetin e tyre që në koordinim me Ministrinë e Integrimit Evropian ta vazhdojnë angazhimin e tyre më të shtuar në procesin e lobimit te shtetet anëtare të Zonës Shengen, me qëllim që ky proces të përmbyllet brenda këtij viti. Po ashtu, anëtarët e komisionit për Integrime Evropiane, si dhe ministrja Hoxha, ranë dakord se nevojitet një bashkëpunim më i theksuar i të dyja palëve, që të ketë koordinim në procesin e lobimit të vizave, në atë mënyrë që të organizohen sa më shpejt takime me përfaqësuesit e shteteve anëtare dhe të merren veprimet e duhura drejt përmbyllјes me sukses të këtij procesi.

## Alternativa: Rezoluta e prezantuar nga pozita ka nevojë për përmirësime

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Alternativa, e cila drejtohet nga Mimoza Kusari-Lila, ka vlerësuar se dokumenti i prezantuar nga pozita për fazën finale të dialogut me Serbinë ka nevojë për diskutim më të gjerë dhe përmirësime substanciale.

Përmes një komunikate për medie ky subjekt politik ka vlerësuar se konsensusi nacional për këtë çështje nuk ndërtohet me veprime të njëanshme. "Partitë në Qeveri duhet të kuptojnë se konsensusi nuk ndërtohet me veprime të njëanshme të tyre, por ai duhet të jetë produkt i një qëndrimi të përbashkët të të gjitha partive politike parlamentare", është thënë në komunikatën e Alternativës, duke shtuar se Alternativa e konsideron të domosdoshme nevojën për platformë të përbashkët të Partive Parlamentare. "Nëse kjo nuk mund të arrihet në këtë çast, atëherë vendi domosdo duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. Ne ritheksojmë se Kosova në dialog me Serbinë nuk mund të përfaqësohet nga presidenti i Kosovës për arsye të dëmeve të deritashme të shkaktuara me veprimet e tij të njëanshme", është thënë në komunikatën e Alternativës.

Alternativa

# Sot i jepet lamtumira e fundit gazetarit Ibrahim Rexhepi

Sot (e martë) në fshatin Slivovë të Ferizajt, në orën 15:30, do t'i jepet lamtumira e fundit gazetarit të njohur të ekonomisë, Ibrahim Rexhepi, i cili ndërroi jetë të hënën në moshën 64-vjeçare



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 TETOR - Në moshën 64-vjeçare ka ndërruar jetë të hënën gazetari i njohur i ekonomisë, Ibrahim Rexhepi, pas një përballje të shkurtër me sëmundjen e leukemisë. Varrimi i tij do të bëhet sot (e martë) në fshatin Slivovë të Ferizajt, në orën 15:30.

Ibrahim Rexhepi ka punuar për shumë vite në gazetën "Rilindja", pastaj në atë "Bujku", si dhe në "Kosova Sot", "Koha Ditore", "Lajm", "Express" dhe revistën "Ekonomia". Ai ishte ndër gazetarët më të vlerësuar dhe ekspert i çështjeve nga fusha e ekonomisë. Vitet e fundit ai ishte angazhuar edhe në politikë, në kuadër të Aleancës Kosova e Re (AKR).

Rexhepi që disa muaj ka ushtruar funksionin e këshilltarit të lartë politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ku ministër është Valdrin Lluka. Ky i fundit i ka shprehur ngushëllime familjes Rexhepi, duke theksuar se ishte nder dhe privilegj të bashkëpunonte me të. "Me dhembje të thellë pranova lajmin për ndarjen nga jeta të bashkëpunëtorit dhe mikut tim Ibrahim Rexhepi. Ibra, për plot 40 vjet, me pasion dhe profesionalizëm të paskajshëm shkruante për çështje ekonomike dhe interesin publik në përgjithësi. Ibra do të përkujtohet gjithnjë si një gazetar frymëzues për brezat e rinj dhe për punën e kontributin e madh në fushën e gazetarisë dhe interesit publik në Kosovë. Sot i shprehi ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ishte nder dhe privilegj të bashkëpunoja me ty, Ibro! Të faleminderit për kontributin!", ka shkruar ministri Lluka në llogarinë e vet në "Facebook".

Pas lajmit për vdekjen e Rexhepit, ka reaguar edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), duke thënë se vdekja e tij "është humbje e madhe për komunitetin e gazetarëve në Kosovë". "Rexhepi do të kujtohet gjithmonë si një profesionist i vërtetë i gazetarisë dhe ekspert i fushës së ekonomisë. Vdekja e tij e parakohshme është humbje e madhe për të gjithë komunitetin e gazetarëve në Kosovë", thuhet në komunikatën e AGK-së.

Edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka ngushëlluar familjen Rexhepi dhe tërë komunitetin e gazetarëve me rastin e ndarjes nga jeta të Ibrahim Rexhepit. "Lajm i trishtë vdekja e gazetarit të njohur Ibrahim Rexhepi. Ishte i çmuar dhe i vlerësuar prej të gjithëve", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryetar i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka shprehur pikëllimin e tij me rastin e ndarjes nga jeta të gazetarit Ibrahim Rexhepi. "Me dhimbje të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të mikut tim Ibrahim Rexhepi. Ibra ishte njeri i urtë dhe ekonomist i zgjuar. Ishte edhe anëtar i devotshëm i AKR-së. Jam krenar që e njoha. Do të na mungosh shumë, miku ynë! Ngushëllime familjes Rexhepi si dhe miqve të tij", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ngushëllime familjes Rexhepi i kanë shprehur edhe përfaqësues të partive politike, deputetë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë të shumtë.

# Më 11 dhe 12 tetor mbahet konferenca ndërkombëtare 'DIGITALKS'

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë më 11 dhe 12 tetor organizon konferencën ndërkombëtare "DIGITALKS". Kjo është Konferenca e parë e këtij formati në Kosovë dhe mbledh më shumë se 1 000 palë të interesuara, politikëbërës të nivelit të lartë, akademikë dhe ekspertë të ekonomisë, të cilët ndajnë dhe shkëmbejnë praktikat dhe politikat më të mira për nxitjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë, me fokus të veçantë për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pjesëmarrës në konferencë do të jenë komisionarja e BE-së për Ekonomi dhe Shoqëri Digjitale, Mariya Gabriel, udhëheqësit më të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës, ministrat përgjegjës për Inovacion dhe Ekonomi nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfaqësues nga James Madison University nga ShBA-ja, përfaqësues nga LSE nga Londra, kryetarët e odave ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ekspertë të fushës së inovacionit dhe ndërmarrësisë nga vendi dhe rajoni.

Përmes konferencës "DIGITALKS" Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë po synon sensibilizimin për rëndësinë e inovacionit dhe ekonomisë digjitale, rritjen e përkrahjes së inovacionit dhe ndërmarrësisë në shërbim të rritjes ekonomike të vendit, si dhe zhvillim të qëndrueshëm për Kosovën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.




# Inaugurohet faza e dytë e impiantit të ujit për pije në Gjakovë

Kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë të hënën në inaugurimin e fazës së dytë të impiantit të ujit për pije në Komunën e Gjakovës. Me këtë rast ai ka kërkuar ndihmën e miqve gjermanë dhe zviceranë që përmes granteve apo huas, të ndihmojnë për zgjidhjen e problemit për trajtimin e ujërave të zeza dhe, po ashtu, për trajtimin e shtretërve të lumenjve



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

GJAKOVË, 8 TETOR - "Ndoshta nuk është e tepërt të them se në këtë vend luftërat nuk do të ndodhin për naftë, por mendoj se lufta për jetën cilësore do të jetë lufta për ujin. Ata popuj, vende që dinë ta respektojnë ujin, ta trajtojnë si duhet, ta ruajnë dhe të sigurohen që të kenë gjithmonë ujë, janë popujt më të mençur", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj me rastin e inaugurimit të fazës së dytë të impiantit të ujit për pije në Komunën e Gjakovës. Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka thënë se ndihet krenar për punën që është realizuar e që është një arritje e të gjithëve.

Duke falënderuar qeverinë gjermane dhe atë zvicerane për kujdesin e madh dhe përkrahjen që kanë bërë për këtë investim në ujë të pijshëm, kryeministri Haradinaj ka pohuar se është me rëndësi për vendin që të krijojë alternativa të tjera të ujëmbledhësve në vend, pasi Kosova është burim i ujit.

Haradinaj ka theksuar se në Kosovë ka ujëmbledhës të shumtë, siç janë, Ujmani, Batllava, Badovci, por mund ta kemi edhe Lepencin dhe ujëmbledhës të tjerë më të vegjël. "Këto janë investimet më strategjike që duhet t'i bëjmë dhe të krijojmë rezerva të ujit dhe me qenë bankë e vetvetes që të mos varemi nga askush për ujin e pijes. Por, jo vetëm kaq: uji është i nevojshëm edhe për të gjitha segmentet e ekonomisë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke i inkurajuar të gjithë që ta fitojnë betejën për ujin e pijes dhe duke kërkuar ndihmën e miqve gjermanë dhe zviceranë që përmes granteve apo huas, të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit për trajtimin e ujërave të zeza dhe, po ashtu, për trajtimin e shtretërve të lumenjve.

Ndërsa kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se "KRU Gjakova", përveçse është një kompani fitimprurëse, ajo ofron edhe shërbime të mira. Kryetari Gjini ka falënderuar për përkrahjen e parezervë që po i jep Qeveria e Kosovës, duke theksuar se nga këto investime po përfiton shumë Komuna e Gjakovës, por edhe Kosova.

Ismet Ahmeti, kryeshef ekzekutiv i "KRU Gjakova", ka theksuar se me ndërtimin e kësaj fabrike do të rritet kapaciteti nga 500 litra në 1000 litra në sekondë dhe kjo ëndërr po bëhet realitet falë Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komunës së Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit, si dhe konsumatorëve tanë.

Një fjalë para të pranishmëve e mbajti edhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë i Republikës së Shqipërisë, Damian Gjiknuri, i cili tha se sfida e ujit është sfida më e madhe që kanë shoqëritë tona. "Ne jemi vende të pasura me ujë, por kemi vuajtur nga investimet dhe menaxhimi", ka thënë ministri Gjiknuri, duke shtuar se sfidat ekzistojnë, por nga kjo që shihet sot, nga gjërat e bëra mirë, mësohet shumë dhe përfitojnë të gjithë.



# Kosova dhe Emiratet e Bashkuara Arabe arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka zhvilluar të hënën takimin bilateral në Abu Dhabi me ministrin e Shtetit për Çështje Financiare, Obaid bin Humaid Al Tayer, me ç'rast ka nënshkruar edhe një marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet ministrive të financave të dy vendeve.

Gjatë takimit ministri Hamza ka falënderuar Emiratet e Bashkuara Arabe për ndihmën e dhënë popullit të Kosovës që nga paslufta e deri më sot. Me këtë rast u diskutua lidhur me mundësitë e investimit që ofron Kosova.

Ministri Hamza e ka njoftuar ministrin Al Tayer për potencialin që ka Kosova si dhe ambientin ligjor shumë të favorshëm për investime.

Ndërkaq ministri Al Tayer ka përgëzuar ministrin Hamza për punën e bërë që dëshmon se Kosova ka stabilitet makro-fiskal, borxh të ulët shtetëror, mbajtje të një sistemi tatimor të ulët që, sipas tij, të gjitha këto e bëjnë Kosovën një shtet të favorshëm për investime.

Po ashtu delegacioni u njoftua për mundësitë e përfitimit nga projektet e ndryshme.

Të dy ministrat u pajtuan për thellim të bashkëpunimit dhe shprehën gatishmërinë për organizim të vizitave të përbashkëta ekonomike.

# Prokuroria Themelore në Ferizaj arreston gjashtë persona

FERIZAJ, 8 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj, pas një pune hetimore katërmuajshe, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Njësitin Antidrogë dhe Inspektoratin Policor, gjatë kontrollimit në tri lokacione, Ferizaj, Kaçanik dhe Prizren, ka sekuestruar 550 gramë substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, një shumë të parave, një peshore digjitale, disa celularë dhe tri vetura të cilat janë sekuestruar përkohësisht, dhe me këtë rast ka arrestuar gjashtë persona, ku një prej tyre është zyrtar policor. Prokuroria Themelore në Ferizaj njofton se me urdhër të prokurorit për personat e arrestuar është caktuar masa e ndalimit 48 orë.





# QKUK-ja me rrugë të reja

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe drejtorin e QKUK-së, Basri Sejdiu, të hënën ka inauguruar rrugët e Qendrës Klinike Universitare. Ky investim i MI-së është realizuar me qëllim që infrastruktura rrugore e këtij institucioni të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës të këtë parametra dhe standarde evropiane dhe ta lehtësojë qarkullimin e lirë e të papenguar të pacientëve, punonjësve dhe vizitorëve.

Ministri Lekaj ka thënë se ky projekt i infrastrukturës ka ndikim pozitiv te pacientët duke u mundësuar qasje më të lehtë në klinikat e QKUK-së. Po ashtu, ai ka theksuar se ndihet mirë që falë bashkëpunimit të MI-së dhe MSh-së ky projekt është realizuar në kohë rekorde.

Ndërkaq, ministri Uran Ismaili dhe drejtori i QKUK-së, Basri Sejdiu, e kanë falënderuar ministrin Lekaj për gatishmërinë dhe veprimet e shpejta që brenda një kohe shumë të shkurtër të asfaltohen rrugët e këtij institucioni shumë të frekuentuar. Rregullimi i këtyre rrugëve ka kushtuar mbi 180 mijë euro dhe gjatësia e rrugëve të asfaltuara nga MI-ja është afro 2.4 kilometra.



# Komuna e Mitrovicës do t'i rrënojë shtëpitë pa leje në Suhadoll

MITROVICË, 8 TETOR (ER) - Bordi i Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit dhe drejtorive komunale.

Vehbi Ahmeti nga Drejtoria e Inspeksionit ka njoftuar anëtarët e Bordit se 19 tetori është caktuar si data për rrënimin e shtëpive të ndërtuara pa leje dhe në pronë publike të cilat ndodhen tek Liqeni Akumulues në Suhadoll, ndërsa që ajo hapësirë është e nevojshme për implementimin e projekteve të papërfunduara në kuadër të projektit të liqenit.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se kjo çështje mund të zgjidhet duke e shfrytëzuar lokacionin i cili gjendet në afërsi të Kompanisë Rajonale Uniteti.

Drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar të pranishmit se Asociacioni i Komunave të Kosovës ka dërguar shkresë për të gjitha komunat, me të cilën njofton se nga tash Drejtoria e Prokurimit, me rastin e shpalljes së tenderëve, si kusht për operatorët duhet ta vendosë edhe kryerjen obligimeve nga tatimi në pronë.

Drejtori Gashi ka kërkuar që drejtorët që t'i zbatojnë vërejtjet e dala nga Raporti i Auditorit, sepse tani e tutje komunat do të shpërblehen ose ndëshkohen varësisht prej përmirësimit të të gjeturave të auditorit.

# Komuna e Malishevës harxhon 70 për qind të buxhetit

MALISHEVË, 8 TETOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive komunale të respektohet dinamika për realizimin e projekteve kapitale. Ai ka kërkuar përgjegjësi nga drejtorët dhe punëkryrësit për realizimin e projekteve. Ndërkaq rreth punëve të infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, ujësjellësit si dhe për dinamikën e projekteve ka dhënë informata drejtori i Urbanizmit, Islam Vrenezi.

Drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi, ka thënë se janë duke vazhduar punët në disa prej objekteve shkollore, renovimet e domosdoshme, të cilat pritet të përfundojnë sa më shpejt, inventarizimi i shkollës në Llazicë, si dhe ka raportuar për furnizimin me lëndë djegëse të shkollave.

Kurse drejtori i Shërbimeve Publike, Milazim Morina, ka apeluar për mbrojtje më të mirë të ambientit, duke kërkuar nga qytetarët dhe bizneset që të kenë kujdes në hedhjen e mbeturinave, po ashtu në këtë drejtim ka kërkuar nga kompania përgjegjëse edhe më shumë angazhim.

Valon Mazreku nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka raportuar se rreth 70 për qind e buxhetit është shpenzuar, kurse realizimi i të hyrave vetjake ka shënuar rritje në realizim rreth 72 për qind.



(Një përmbledhje telegrafike e ngjarjeve dhe e akteve juridike me fuqi ndërkombëtare që e bëjnë me fuqi të plotë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës)

# RRUGA JURIDIKE E KOSOVËS PAS LUFTËS ÇLIRIMTARE



Shkruan: Jakup KRASNIQI

**Hyrje**

(Pa hyrë në aktet juridike të para luftës çlirimtare)

Pas luftës çlirimtare rruga juridike (ligjore) e Kosovës është nisur me Rezolutën 12 44 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 10 qershor 1999, nga e cila më vonë ka dalë Korniza Kushtetuese për ndërtimin e Institucioneve të Vetëqeverisjes së Kosovës me Administrimin Ndërkombëtar në Kosovë, e quajtur UNMIK, e cila ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001. Korniza Kushtetuese qe nënshkruar nga kryeadministratori i UNMIK-ut në Kosovë, Hans Haekerupp.

Shtatë vjet pas çlirimit të Kosovës, me ndërmjetësimin e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisarit, janë zhvilluar në Vjenë (2006-2007) bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Bisedimeve i kanë paraprirë Raporti i Kai Aides e më pas Deklarata e Grupit të Kontaktit mbi parimet e së cilës janë zhvilluar bisedimet dhe në fund ka rezultuar Dokumenti Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, i njohur ndryshe edhe si Dokumenti i Presidentit Ahtisari ose Pakoja e Ahtisarit.

Në fillim ishte planifikuar që mbi bazën e Dokumentit Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, Këshilli i Sigurimit do ta shfuqizonte Rezolutën 12 44 dhe me një Rezolutë të re do ta njihte Pavarësinë e Kosovës. Ky ndryshim u pengua nga vetoja ruse në KS.

Pastaj Kosova, në koordinim me faktorin ndërkombëtar, zgjodhën rrugën e shpalljes se Pavarësisë nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës. Më 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës u votua Deklarata e Pavarësisë. Deklarata e Pavarësisë, e shpallur në Kuvend, e shpalli Kosovën shtet të pavarur sovran dhe demokratik. Pas këtij akti të lartë juridik kanë filluar njohjet ndërkombëtare dhe deri tani Kosovën e kanë njohur 116 shtete, anëtare të OKB-së.

Një akt tjetër i rëndësishëm ndërkombëtar ka qenë edhe Vendimi i GjND-së i publikuar më 22 korrik 2010 lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Mbi bazën e të gjitha akteve juridike veç të fundit, më 15 prill 2008 është miratuar Kushtetuta e Kosovës e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor të atij viti.

**Strategjia e Kosovës për dialog me Serbinë sipas Kushtetutës së Kosovës**

Kushtetuta e Kosovës, akti më i lartë i shtetit, askujt nuk ia jep të drejtën ta ndryshojë apo tjetërsojë tërësinë territoriale të Kosovës. Kushtetuta e Kosovës në nenin e saj të parë saktëson se: "Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pavarur".

Ndërsa në paragrafin e dytë të nenit dy, saktëson: "Sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj".

Ndërsa në nenin 18 të Kushtetutës shkruan: "Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës".

Këto nene të Kushtetutës, në mënyrë më të saktë të mundshme mbrojnë tërësinë territoriale, sovranitetin e shtetit dhe mbrojnë këtë me të gjitha mjetet kushtetuese që i ka Republika e Kosovës. Në të njëjtën kohë, Kushtetuta jonë përcakton qartas detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit më të lartë të shtetit, Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës është i vetmi institucion kushtetues që e ka të drejtën për miratimin e Kushtetutës dhe ndryshimin e saj me dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, gjithashtu me 2/3 e deputetëve të Kuvendit.

Mbi bazën e të gjithë dokumenteve juridike (ligjore), vendore dhe ndërkombëtare, të nxjerra mbi bazën dhe në mbrojtjen e kufijve ekzistues të Kosovës dhe të qartësuara e të sanksionuara në aktin më të lartë të shtetit, në Kushtetutën e Kosovës. Më 7 shtator 2012 Kuvendi i Kosovës e ka hequr pavarësinë e mbikëqyrur, me aktin e fundit është përmbyllur pavarësia dhe sovraniteti i institucioneve të Republikës së Kosovës. Edhe akti i fundit është bërë në bashkëpunim të plotë me komunitetin ndërkombëtar, e veçmas me BE-në dhe ShBA-në. Natyrisht, për të gjitha këto çështje në Kosovë kishte edhe konsensus të gjerë nacional.

Duhet ta themi se pa Lëvizjen Kombëtare për Çlirim dhe veprën kulmore të saj, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe pa flijimin biblik të shqiptarëve në krye me Adem Jasharin, nuk do ta kishim çlirimin e Kosovës. Nuk do të kishim as një akt juridik ndërkombëtar të përmendur, pra as pavarësinë e sovranitetin dhe Kushtetutën si akt bazik të shtetit. Gjithashtu, duhet të themi se pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së dhe BE-së nuk do t'i kishim as 116 njohjet e shteteve anëtare të OKB-së.

Të përfundojmë. Dialog me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve tona po, por jo pa konsensus nacional dhe pa asnjë kompromis tjetër veç atij që pala e Kosovës e ka bërë në bisedimet e Vjenës. Ato bisedime patën përfunduar me Pakon e Ahtisarit mbi bazën e të cilit dokument është shpallur pavarësia e Kosovës. Kompromiset e palës shqiptare të përfshira në atë dokument i janë të njohur Komunitetit Ndërkombëtar.

Çdo kompromis tjetër, i cilitdo nivel qoftë, do të jetë kompremetim i cili shtetin e Kosovës e bën jofunksional!



## Kastrati shpërndan 20 makina mjelëse për fermerët e Dardanës

**Kamenicë, 8 tetor (ER)** - Kryetari i Komunës së Dardanës, Qëndron Kastrati, ka bërë shpërndarjen e 20 makinave mjelëse për fermerët e kësaj komune. "Sot kisha kënaqësinë që së bashku me drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, z. Naim Arifi dhe përfaqësuesen e Grupit të Veprimit Lokal (GLV), znj. Lirije-Hajrizi Dërmaku, ta bëjmë shpërndarjen e 20 makinave mjelëse për fermerët që merren me blegtori. Në bashkëpunim me Grupin e Veprimit Lokal-Kamenica dhe me mbështetjen e Projektit Aftësitë për Punësim Rural/Helvetas Swiss Intercooperation, bëmë të mundur sigurimin e këtyre 20 makinave mjelëse që do të jenë ndihmesë për fermerët", ka thënë Kastrati. Ai ka thënë se këto makina do t'i ndihmojnë fermerët që ta rrisin sasinë e prodhimit dhe përmirësojnë cilësinë e qumështit. "Rritja e sasisë së prodhimit të qumështit do të rezultojë me të ardhura më të mëdha për fermerët e zonave rurale. Bashkë me GLV-në do të jemi më afër fermerëve të blegtorisë me këshilla praktike, pa i anashkaluar edhe fermerët e tjerë si bletarët e pemëtarët", është shprehur Kastrati.



## Ish-ministrja e Maqedonisë dënohet me 6 vjet burgim



**Shkup, 8 tetor** - Gjykata penale në Shkup i caktoi dënimin me burgim prej gjashtë vjetësh ish-ministres së Punëve Bë brendshme, Gordana Jankullovska, e akuzuar për mënyrën e paligjshme të blerjes së një veture të tipit Mercedes, para gjashtë vjetësh.
Vendimi u mor nga Këshilli gjyqësor prej pesë anëtarëve të kryesuar nga gjykatësja Dobrilla Kacarska.
Rasti u zbulua me publikimin e skandalit të përgjimeve para tre vjetësh.
Në bisedat telefonike, mes tjerësh dëgjoheshin ish-minstrja e rendit dhe ish-kryeministri Nikolla Gruevski duke biseduar për hollësitë se çka duhej të përmbajë vetura Mercedes S 600 Guard, e blinduar, që do të përdorej për nevojat zyrtare dhe private të Gruevskit.
Në këtë proces qe favorizuar një kompani maqedonase, për ta sjellë në Shkup makinën nga prodhuesi gjerman. Mercedes Benzi kishte kushtuar 600 mijë euro.
Prokuroria e posaçme, e cila ngriti akuzat kundër Jankullovska dhe pala mbrojtëse e saj kanë të drejtë për ankesa tek gjykata e shkallës më të lartë, Gjykata e Apelit.

# Partia e Gjelbër dhe roli i saj në politikën e Gjermanisë

Anketat tregojnë se në prag të zgjedhjeve të 14 tetorit në Bavari, Partia e Gjelbër është në vend të dytë dhe kjo mund ta bëjë këtë parti një faktor kryesor për çdo koalicion qeveritar

**Berlin, 8 tetor** - Fuqizimi i së djathtës ekstreme në Gjemani është fakt, por në shtetin jugor të Bavarisë, populariteti i së djathtës po eklipsohet nga opozita në spektrin politik. Anketat tregojnë se në prag të zgjedhjeve të 14 tetorit në këtë shtet, Partia e Gjelbër është në vend të dytë; kjo mund ta bëjë këtë parti një faktor kryesor për çdo koalicion qeveritar. Politikanët e krahut të majtë në mbarë Evropën po e ndjekin me interesim situatën politike në Gjermani, ndërsa përpiqen të gjejnë mënyra për t'iu kundërvënë fuqizimit të së djathtës ekstreme.
Në kryeqytetin e Bavarisë, Mynih, festa tradicionale e birrës është në kulmin e vet dhe për Katharina Schulze, shumë shpejt mund të ketë edhe një tjetër arsye për të festuar.
Bashkëkryetarja 33-vjeçare e Partisë së Gjelbër të Bavarisë thotë se ndjen që kjo ka për të ndodhur. Ajo kryeson garën me kandidatin e Socialdemokratëve të qendrës së majtë dhe atë të Alternativës për Gjermaninë, të së djathtës ekstreme. "Ajo që sot shqetëson njerëzit, është se flitet shumë për urrejtje, ka një shtim të gjuhës së urrejtjes. Ne nuk fokusohemi te kjo. Sigurisht, që ka sfida që duhet t'i trajtojmë me guxim, por na duhen zgjidhje dhe ide të zgjuara - jo gjithmonë me ankesa, se sa keq janë punët", thotë Katharina Schulze.
Ky është një mesazh që duket se rezonon me situatën. Partia e Gjelbër po merr votat e Socialdemokratëve në disa qytete gjermane. Udhëheqësit e saj mbështetin një program tërësisht të ndryshëm - kufij të hapur, integrim më të madh evropian dhe thonë se Gjermania duhet të jetë krenare që ka pranuar mbi një milion refugjatë. "Në një kohë kur ekziston frika për fuqizimin e së djathtës ekstreme dhe për një Gjermani të mbyllur, kjo situatë po funksionon mirë për ta", thotë analisti i shkencave politike, Julian Gopffarth.
Fuqizimi i së djathtës ekstreme është mbuluar gjerësisht nga media. Sipas anketave, partia anti-imigracionit AfD, është në vend të tretë. Por Të Gjelbrit mendojnë se ka ardhur momenti i përshtatshëm për ta. "Sigurisht, që lajmet fokusohen gjithmonë te ngjarjet më shokuese. Prandaj mendoj se Partia e Gjelbër nuk ka mbulim po aq të madh sa Partia AfD dhe fuqizimi i saj", thotë analisti Gopffarth.


VOA

Të Gjelbrit kanë mësuar nga sukseset e rivalëve të tyre, duke zbatuar disa nga taktikat që kanë tërhequr mbështetje për ekstremin e djathtë; ata po theksojnë lidhjet lokale të kandidatëve të tyre. "Duke theksuar edhe disa nga kauzat e AfD-së. Çështja e Atdheut, për shembull; ata përpiqen ta theksojnë atdhedashurinë nga perspektiva e politikave të gjelbra, nga pikëpamja ekologjike", thotë analisti Gopffarth.
Duke u nisur nga ky këndvështrim, Të Gjelbrit i kanë kritikuar disa projekte të mëdha ndërtimi, si sulme ndaj mjedisit të Bavarisë. Por a do të sillte theksimi i çështjeve ekologjike fuqizimin e populizmit të gjelbër në Evropë?", thotë analisti Gopffarth.
"Janë disa aspekte, të cilat ndikojnë te suksesi i Partisë së Gjelbër, të cilat mund t'i shohësh në shumë vende evropiane: dobësimi i dy partive kryesore politike, të qendrës së majtë dhe të djathtë, që i çojnë njerëzit drejt ekstremeve, qofshin këto të dyerve të hapura, apo izolimit", thotë analisti politik Leopold Traugott.
Sfida për Partinë e Gjelbër është ta shtrijë këtë situatë të favorshme që ka në Bavari, edhe më gjerë, në Gjermani dhe në Evropë. Shumë analistë janë skeptikë, por fragmentimi i politikës evropiane po merr tani një ngjyrim të ri.

# Manovra ushtarake ajrore NATO-Ukrainë



**Kiev, 8 tetor** - Rreth 700 ushtarë nga tetë vende të NATO-s dhe Ukraina, si dhe rreth 40 avionë, mes të cilëve edhe luftarakë amerikanë model F-15, që nga e hëna marrin pjesë manovrat në perëndim të Ukrainës, nën sfondin e krizës me Rusinë fqinje. "Kjo është hera e parë që forcat ajrore do të punojnë së bashku për t'u stërvitur që të mbrojnë hapësirën ajrore", njoftoi zëdhënës i forcave ajrore ukrainase, Juri Ignat.
Tetë vende anëtare të NATO-s, ShBA-ja, Britania e Madhe, Belgjika, Danimarka, Estonia, Holanda, Polonia dhe Rumania, marrin pjesë në këto manovra të quajtura "Clear Sky 2018", sipas Ministrisë ukrainase të Mbrojtjes.

## Kina thotë se shefi i Interpolit është nën hetime

**Pekin, 8 tetor** - Kina tha se është duke e hetuar shefin e Inerpolit, Meng Hongwei, nën dyshime për keqbërje, dy ditë pasi që ai u raportua si i zhdukur.
Të premten policia u njoftua nga bashkëshortja e tij, e cila jeton në Lion, ku ndodhet selia qendrore e organizatës ndërkombëtare të policisë se në fund të shtatorit, Meng Hongwei ishte nisur për në Kinë dhe prej atij momenti nuk është bërë më i gjallë. "Meng Hongwei është aktualisht nën hetime nga Komisioni Mbikëqyrës Kombëtar, nën dyshimet për shkelje të ligjit", u tha në një komunikatë të shkurtër të Agjencisë kineze kundër korrupsionit.
Interpoli tha më vonë se Meng ka dhënë dorëheqje dhe Kim Jon Yang nga Koreja e Jugut do të jetë ushtrues detyre. Shefi i ri do të zgjidhet në takimin që mbahet nga 18 deri më 21 nëntor në Dubai.
Interpoli tha më herët se kishte kërkuar nga Kina që të sqarojë situatën e Meng. "Më 7 tetor, sekretariati i përgjithshëm i Interpolit në Lion të Francës, mori letrën e dorëheqjes së Meng Hongwei si president i Interpolit, e cila hyn në fuqi menjëherë", thuhet në një deklaratë të Interpolit.



# DOLI NGA SHTYPI LIBRI I DHJETË I PROF. DR. IUR. EQREM ZENELAJ "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË VEPRAT E ARTISTËVE EVROPIANË"



E rrallë

## Balena gjigante tmerron anijen me turistë



Një balenë gjigante doli për të bërë një fluturim në ajër, por lagu një anije me turistë në Kosta Rika. Pamjet janë filmuar nga një person që po shihte krijesën dhe anijen nga gjiri i Queopos. Kamera e tij u fokusua menjëherë tek hedhja e anijes. Turistët dëgjohen duke bërtitur pasi ishin të tmerruar nga ajo çfarë panë.

FOTO E DITES



Një grua ecën përgjatë një ure në një lartësi prej 2 320 metrash në vendpushimin e skive Rosa Khutor në Rusi. /TASS/

E jashtëzakonshme

## Banorët ankohen në polici për zogjtë




Policia në një komunitet të vogël të Minesotës veriore ka marrë disa telefonata të çuditshme për zogjtë që duken si të dehur. Qytetarët në Gilbert kanë raportuar se zogjtë fluturojnë të hutuar në dritare dhe në makina. Në një mesazh në "Facebook", departamenti i policisë thotë se ka një shpjegim të thjeshtë për rastin: "Zogjtë hanë fruta të fermentuar më shpejt këtë vit për shkak të një acari në zonë".

## BARSOLETA E DITËS



**Një çift po përgatitej për mbrëmjen e madhe të karnavaleve.**
**- Unë do të martohem si kloun, - thotë burri.**
**Dhe e shoqja:**
**- Të lumtë! Kështu të gjithë do të njohin menjëherë.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**





**Në ora 16:00**

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

**Në ora 18:00**

### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee







**Në ora 20:00**

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

**Në ora 22:00**

### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Keni zgjedhur një rrugë të mesme sot për t'i arritur objektivat tuaj. Edhe pse do të keni kritika, jeni ju që merrni vendimet për veten.



**DEMI** Po hidhni argumente që nuk jeni të gatshëm t'i mbështesni në ditët në vijim. Mbase një ndryshim strategjie do të ishte më i mirë.



**BINJAKËT** Puna për ju sot do të jetë një burim kënaqësie. Bashkëpunimi me kolegët ju ka bërë që të përfitoni bonuse mjaft të mira morale dhe materiale.



**GAFORRJA** Po lini pas dore raportet tuaja personale, sidomos ato që u përkasin ndjenjave. Kur t'i kërkoni miqtë tuaj do të vini re distancat.



**LUANI** Nëse nuk jeni të kënaqur nga ajo që po bëni kohët e fundit, është mirë të ndaleni dhe të mendoni qartë se kush është prioriteti juaj.



**VIRGJËRESHA** Doni t'i vazhdoni projektet që keni nisur, por rrethanat nuk do t'ju lejojnë ta bëni këtë gjë. Ndryshoni drejtim në kohën e duhur.



**PESHORJA** Gjëja më e mirë është heshtja kur shihni se përreth jush situatat dhe personat janë duke krijuar rrëmujë. Më pas gjithçka do të qartësohet.



**AKREPI** Personat gri që rrinë rreth jush nuk kanë pasur asnjëherë asnjë ide dhe nuk ju kanë propozuar asgjë deri tani. Bëni mirë të bëni dallime.



**SHIGJETARI** Sot duhet të vepronì vetëm për veten tuaj. Duke marrë rolin e të tjerëve i keni hequr vetes mundësitë të dëgjoheni në ambiente të ndryshme.



**BRICJAPI** Jeni të pavarur në vendimet tuaja sot dhe kjo ju ka krijuar mjaft liri veprimi. Përfitimet e kësaj gjëje do t'i përjetojnë edhe familjarët tuaj.



**UJORI** Keni kërkuar prej kohësh mënyrën më të mirë për të zgjidhur disa ngërçe që po verifikohen në ambientin e punës. Nëse nuk ia dilni, mbase është momenti të ndaloni.



**PESHQIT** Entuziazmin e munguar po filloni ta gjeni përsëri sot në detaje të vogla dhe në ambientin e ngrohtë familjar.



# GURI I KOBSHËM



SADIK KRASNIQI

Kronisti nga pozita e tij e mbuluar me një çadër të rrjepur dhe të zverdhur nga dielli nuk mundte të shikonte shumë larg dhe nuk e dinte se nga vinin këta gurë gjigantë të gdhendur me një simetri të përsosur. Nuk dinte nga vinin ata të gatshëm dhe aq të ngjashëm, në vinin përtej rëre, përtej deti apo zbrisnin nga qielli. Para binës së tij kalonin kuaj të zi, deve ngjyrë rëre dhe njerëz të përgjakur që tërhiqnin gurët e rëndë drejt majës së ngrehinës. Përbri tyre ecnin gratë brune me petka të bardha që mbulonin vidhet e rregullta dhe gjinjtë e bukur. Gratë mbanin në kokë bukë e hurma, ndërsa dy duart i kishin të zëna me ibrikë plot ujë e verë. Kronisti i pozicionit të mesit, me bisht të syrit shikonte gjinjtë e njomë dhe kofshët e zbuluara të vajzave të reja që përkuleshin mbi të plagosurit duke u vërë melhem mbi plagët që kullonin gjak të nxehtë. Kudo dëgjoheshin hingëllima, blegërima e britma që mbuloheshin me fishkëllimin e kamxhikëve që binin si vetëtima mbi lëkurat e kafshëve e të njerëzve. M'u atëherë kur ishte kërrusur si i humbur mbi hieroglifët me të cilët përshkruante situatën e çastit dhe numrat me të cilët numëronte gurët që tërhiqeshin lart, dëgjoi britma të shoqëruara me këngë dhe valle që shkonin pas gurit kubik.
Duke parë këtë gur u drodh dhe i ra terri syve.
Për një kohë mbajti sytë e mbyllur, sikur donte ta provonte se si do të dukej jeta pa sy.
Guri i madh kubik i shoqëruar me këngë dhe valle, ishte guri i fundit drejt Piramidës së fundit. Ai gurëmajë ishte kobi vetë. Pas disa ore do të jetë buzë majës së piramidës së madhe, po që nuk do vihej para muzgut. Muzgu do ta sillte yllin orientues, sipas të cilit, edhe ishte nisur piramida. Përndritja e këtij ylli do të ishte edhe muzgu i fundit për shumë njerëz që ishin të veçantë përgjatë ndërtimit njëzetvjeçar të kësaj ngrehine. Këta njerëz do të vriteshin ose do të shëmtoheshin asisoj, që mos të ishin në gjendje të dëshmonin për së gjalli të tyre mënyrën e ndërtimit të Piramidës unike.
Vdekja apo shëmtimi i tyre do të bëhej e njohur me anë të dekretit të vulosur me dyllë të lëshuar nga Faraoni.
Kronisti i zbehur dhe i mbuluar nga djersët e ftohta, mori dekretin sekret duke mos e shikuar njeriun që e solli atë. Kumti i dekretit në mes të gishtërinjve që dridheshin u lexua fluturimthi dhe me një shpejtësi marramendëse, por u kuptua qartë vendimi: "Kronistit të pozicionit dy, do t'i prehet gjuha dhe gishtërinjtë, që mos të rrëfejë e as të shkruajë numrin e gurëve që ka marrë piramida".
Këtij i ra dielli në kokë dhe iu errësuan sytë. Si i dehur, iu afrua urnës së madhe e të nxehtë, i hoqi kapakun nga rrasa e gurit të zi, futi kokën brenda dhe duke u mbajtur për dy vegët si dy vesh të urnës, qëndroi disa sekonda, derisa u plandos në rërë duke mbuluar fytyrën me duart tashmë të vdekura. Ndërsa nga urna e rrëzuar doli një gjarpër i gjatë ngjyrë rëre dhe duke u përdredhur, humbi nën dunat që i merrte era.

## ATA

I dukej vetja si i shpikur në mesin e atyre njerëzve me pamje të çuditshme. Mundohej të bëhej i pavërejtur dhe t'u ikte vështrimeve të tyre indiferente. Duke mos guxuar t'i vështronte drejtpërdrejt, bëri sikur shikonte në vitrinat e shitores së madhe me xhama blu, në të cilët reflektohej fytyra e tyre e çuditshme prej katrori në kokat kub. Goxha gjatë kishte qëndruar para xhamave blu, duke vërejtur në detaje ato koka me profile këndrejta. Në vështrimin e vëngër drejt tyre, i lindi dilema se këto pamje kishin dalë nga pikturat e Pikasos, apo pikturat e Pikasos ishin shëmbëllesë e tyre!
Mbylli për një çast sytë, me shpresën se krejt kjo që shihte, të ishte një halucinacion mirazhi. Duke ndier sikur në çdo moment do të ndiente prekjen e tyre të beftë në krah, vendosi ta vazhdonte udhën pa ndonjë cak. U gëzua që një grimcë kohe mund ta kalonte duke kujtuar lotin e derdhur nga mallëngjimi i piktorit të madh Ibrahim Kodra në Prishtinë. Mandej me këtë lotmalli dhe duke kujtuar pikturat me kësilloj formash e këtij krijuesi kishte kaluar një copë rrugë.
Për një çast, për çudi, ishte gjendur mu në mes të turmës së njerëzve me koka kubi. Edhe pse kishte lexuar dhe dëgjuar për labirinte të ndryshme, si atyre të shkretëtirës, të kështjellave e pyllnajave e të nëntokës, kurrë nuk i kishte vajtur mendja që një ditë edhe vetë do të gjendej në një labirint kaq të çuditshëm në pikë të ditës dhe në mes qytetit të vet.
Kudo kah shikonte, shfaqeshin fytyrat me koka kubike me sytë e xhamtë që shponin me kërshëri. Duke parë shikimin e tyre si prej shigjete, e tmerroi një mëdyshje, se mos vallë ky vetë ishte i jashtëzakonshëm e jo ata me kokat e tyre katrore!
Edhe ata filluan njëherazi ta shikonin. Në vështrimin e tyre vërehej urrejtja dhe përbuzja. Duke folur në gjuhë krejt të huaj si nga një kozmos tjetër, filluan t'i afrohen dhe ta preknin beftë. Ky i motivuar nga një ndjenjë e një qenie me pamje normale, filloi t'i kundërvihej me sigurinë e një të rrituri ndaj fëmijëve. Tingëllima e një kokëkubi të përplasur në mur nga shtyrja që i kishte bërë, kishte kthyer vëmendjen e të gjithë qenieve me kokë kubi duke vrapuar drejt tij. Filluan ta preknin e, më vonë, ta godisnin duke e çuar peshë nga toka dhe duke e bartur si një qese plastike në ajër. Përplasja e tij për toke sikur e pruri në vete. Duke u orientuar me majat e gishtërinjve zuri një karrige, u ul i dërrmuar dhe qull nga gjaku a djersa. Vendosi mos t'i çelte sytë për ta parë edhe një herë atë specie të çuditshme me ato koka kubi!



HALIL SELIMI

## Pa vendlindje s'ka liri!

*Nga ti u nisa drejt lirisë,*
*Vendlindja ime, Luginë!*
*Dhe, ende s'po arrij te ti!*
*Nuk më mjafton liria pa ty!*




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| ORGRYTE V DEGERFORS | 1 | PAYSANDU - CRB | 1 | SEATTLE - HOUSTON | 1 |
|---|---|---|---|---|---|

# Challandesi: Primare paraqitja e mirë e Kosovës, jo rezultatet

Kosova ka marrë rezultate të mira në dy ndeshjet e para të Ligës së Kombeve, por trajneri Bernard Challandes ka thënë të hënën se me rëndësi është që "Dardanët" të paraqiten mirë. "Asnjëherë para ndeshjes nuk them se do t'i fitojmë aq apo kaq pikë, por primare për mua është paraqitja e mirë e futbollistëve dhe ekipit", ka thënë Bernard Challandes




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Berndard Chalandes, nuk ka dashur të japë ndonjë parashikim se a do të fitojë Kosova gjashtë pikë në dy ndeshjet e radhës në Ligën e Kombeve ndaj Maltës dhe Ishujve Faroe. Trajneri zviceran ka thënë se me rëndësi është paraqitja e mirë e futbollistëve dhe ekipit. "Asnjëherë para ndeshjes nuk them se do t'i fitojmë aq apo kaq pikë, por primare për mua është paraqitja e mirë e futbollistëve dhe ekipit. Nuk do të thotë se një futbollist që ka lojë shumë me ekipin e tij domosdo të jetë në përfaqësuese, apo ai që nuk ka asnjë lojë të mos ketë vend në përfaqësuese, sepse shpesh ata që kanë lojë shumë mund ta ndiejnë lodhjen e ata që nuk kanë lojë ndiejnë se kanë forcë dhe rastin të tregohen", ka thënë Challandes, i cili më pas ka folur edhe për futbollistin e rikthyer në përfaqësuese pas një kohe të gjatë, Valon Berishën e Lazios.

Ai fjalë të mira pati edhe për Lirim Kastratin që po shkëlqen në kampionatin kroat të futbollit. "Ndihem i lumtur që Berisha është kthyer në përfaqësuese, sepse është një futbollist i shkëlqyer. Lirim Kastrati është një lojtar i mirë, ka luajtur për U-21 dhe është lojtari më i mirë në kampionatin kroat, i cili ka shpejtësi dhe është i ri. Prandaj dyert e përfaqësueses janë gjithmonë janë të hapura për lojtarët e rinj", ka deklaruar Challandes, duke i lënë të hapura dyert e përfaqësueses edhe për lojtarët që luajnë në kampionatin vendor.

I pyetur për mungesën e Bersant Celinës, tekniku zviceran është përgjigjur: "Bersanti është një lojtar shumë i mirë, por këtë radhe kemi menduar se nuk është koha e duhur që ai të jetë me ne".

Një futbollist shqiptar nga Kosova që vazhdon të jetë i pavendosur për të ardhmen e tij është edhe Florent Hadërgjonaj. Challandesi lidhur me këtë rast ka thënë se Florenti duhet ta ketë si të domosdoshme paraqitjen për vendin e tij. "Ai duhet të jetë i vendosur që të luajë për Kosovën dhe ta konsiderojë së të domosdoshme që të luajë për shtetin e vet dhe jo Kosovën ta mendojë si rezervë. Disa herë kemi kontaktuar me të dhe asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje të saktë. Prandaj ai dhe të tjerët që mendojnë të vijnë të luajnë për Kosovën duhet ta thonë qartë dhe me vendosmëri", ka shtuar Challandes.

Kosova më 11 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret Maltën, kurse tri ditë më vonë i shkon Ishujve Faroe.

### Tifozët, interesim të madh për bileta

Federata e Futbollit e Kosovës ka vendosur që biletat të vihen në shitje të hënën nga ora 17:00, kurse interesimi ka qenë shumë i madh nga tifozët, të cilët, disa orë para se të hapen pikat e shitjes, janë grumbulluar për të siguruar një biletë e cila i mundëson të shohin nga afër ekipin e zemrës. Kësaj radhe FFK-ja ka vendosur që vetëm pesë bileta mund të blihen nga një person, në mënyre që të shmanget çfarëdo lloj keqpërdorimi.

# Ramadani publikon listën për ndeshjet me Poloninë dhe Gjermaninë



Prishtinë, 8 tetor - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës në Hendboll, Taip Ramadani, ka publikuar listën e lojtarëve që do të paraqiten në dy ndeshjet e para të fazës së dytë të kualifikimeve për Kampionatin Evropian të vitit 2020. Kosova është në grupin e parë së bashku me Gjermaninë, Poloninë dhe Izraelin. Më 24 tetor Kosova luan me Poloninë në Ostrowiec, kurse më 28 tetor e pret kombëtaren e Gjermanisë, që është prej më të mirave në botë. Në listën e selektorit Ramadani janë 18 lojtarë, 12 prej tyre të klubeve të Superligës së Kosovës. Besa Famgas përfaqësohet nga pesë lojtarë, Prishtina nga tre, Kastrioti i ka dy lojtarë, ndërsa Drita e Vëllaznimi nga një. Lojtarë të klubeve të huaja në kombëtare ka nga Gjermania, Suedia dhe Zvicra. Ata do të bashkohen me kombëtare në Turqi më 20 dhe 21 tetor. Në kuadër të përgatitjeve për dy ndeshjet kualifikuese, kombëtarja jonë luan dy ndeshje kontrolluese ndaj Turqisë, më 21 e 22 tetor. Grumbullimi i kombëtares, përkatësisht i lojtarëve të Superligës, do të bëhet më 17 tetor, ndërsa përzgjedhësi Ramadani do të ndihmohet nga trajnerët Fadil Kqiku e Erhan Shahini, trajneri i portierëve Veton Hajrizi, ai i përgatitjes fizike Enver Tahiraj dhe fizioterapeuti Agon Bytyqi.

**LISTA E HENDBOLLISTËVE**

**Arbër Curri, Beni Sula, Kastriot Jupa, Kreshnik Krasniqi, Florim Hoxha, Dymal Kërnaja, Lindrit Fetahu, Enis Kabashi, Fatlum Ahmeti, Deniz Terziqi, Oltion Beshiri, Endrit Abdullahi,Luigj Quni, Drilon Tahirukaj, Haris Berisha, Mursel Mehmeti, Bujar Ramosaj, Bujar Ramosaj, Fidan Cimili.**

## Besa paraqitet mirë, por humbet në Norvegji

PRISHTINË, 8 TETOR - Kampionia e Kosovës në Hendboll, Besa Famgas, është paraqitur fuqishëm të dielën përballë nënkampionit të Norvegjisë, Drammenit. Ndeshja e luajtur në Drammen të Norvegjisë para 600 shikuesve ishte e para e rrethit të dytë të Kupës së EHF-së. Në fund Drammeni fitoi me 11 gola dallim, por rezultati 37:26 nuk e dëshmon atë që skuadrat e shfaqën në fushën e lojës. Rezultati është dashur për disa gola të jetë më i ngushtë, në bazë të asaj që djelmoshat e Arben Muqollit kanë shfaqur. Thuajse vazhdimisht lojtarët e Besës ishin rivalë të barabartë me ata të Drammenit.

Drammeni është skuadër me përvojë të gjatë në Evropë, ndërsa në përbërje ka edhe reprezentues të Norvegjisë, që është prej vendeve evropiane me hendbollin më të zhvilluar. Nga pakujdesia lojtarët e Besës në fund të takimit pranuan shumë gola, që nuk është dashur t'i pranojnë. Por paraqitja në Norvegji jep shpresë për një paraqitje edhe më të mirë të shtunën tjetër në Pejë kur luhet ndeshja e kthimit. Lojtarët e Besës kanë dëshmuar se mund të maten edhe me lojtarë të një skuadre cilësore si Drammeni. Besa në rrethin e parë e kishte eliminuar Batumin e Gjeorgjisë. Fundjavën tjetër ndeshje evropiane kanë edhe Kastrioti dhe Prishtina. Do të jetë një fundjavë hendbolli, siç është edhe i tërë muaji.

## Pensionohet John Terry



LONDËR, 8 TETOR - Një emër i madh i futbollit anglez dhe atij evropian është tërhequr nga futbolli. John Terry ka vendosur t'i varë këpucët në gozhdë, ndërsa ka shkruar një koment në rrjetet sociale. Falënderime për të gjithë si një kapiten i vërtetë nga ana e mbrojtësit, duke filluar nga Chelsea, klubi i tij i zemrës, ku kaloi 11 sezone si profesionist, por dhe klubet Notingam Forest dhe Aston Villa, me të cilët ka përjetuar përvoja të shkurtra. "Pas një karriere të gjatë prej 23 vjetësh vendosa t'i them lamtumirë futbollit të luajtur. Më duhet të falënderoj shumë persona: gruan time, Torin, fëmijët e mi Samer dhe Xhorxhi, prindërit e mi dhe vëllanë tim. Pa sakrificat e tyre, këshillat dhe dashurinë, asgjë nuk do të ishte e mundur. Në moshën 14-vjeçare bëra zgjedhjen për të firmosur me Chelsean. Nuk e harroj kurrë mbështetjen e tyre. Nga drejtuesit te tifozët, keni qenë më të mirët në botë. Falënderoj trajnerët, presidentët dhe shokët e skuadrës me të cilët kam ndarë 717 ndeshjet e mia. Ka qenë një nder të jem kapiten. Falënderoj dhe Notingam Forestin dhe Aston Villën. Tani fillon një kapitull i ri i jetës sime dhe jam gati për sfidat e reja", ka shkruar Terry.

# Pullë postare me imazhin e legjendës Fadil Vokrrit

PRISHTINË, 8 TETOR - Në kuadër të tematikës "Legjenda e futbollit - Fadil Vokrri", Posta e Kosovës ka emetuar të hënën një pullë postare me imazhin e legjendës së futbollit të Kosovës, të ndjerit Fadil Vokrri. Me këtë rast, kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, me bashkëpunëtorë, në ambientet e hotelit "Emerald" në Prishtinë organizoi promovimin e pullës postare, me ç'rast priti Kryesinë e Federatës së Futbollit të Kosovës, anëtarë të familjes Vokrri dhe mysafirë sportdashës të tjerë. Ai u dhuroi në pllakë bronzi pullat e para familjes dhe përfaqësuesve të FFK-së. "Ne jemi shumë krenarë që po e promovojmë një pullë postare shumë të çmueshme që i kushtohet figurës të talentit më të njohur të futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Ndarja shumë e hershme e të madhit Fadil Vokrri në qershorin e këtij viti, na i theu zemrat e na pikëlloi të gjithëve, por veprat e tij do të mbesin gjumë të pashlyeshme te shqiptarët brenda dhe jashtë vendit. Fadil Vokri hyri në histori jo vetëm për kontributin në fushën e gjelbër brenda dhe në arenën




ndërkombëtare, por edhe për kontributin që dha për ndërkombëtarizimin e futbollit të Kosovës. Emri i legjendës Fadil Vokrri, ashtu siç u përjetësua në stadiumin e Prishtinës nga sot e mot, do të përjetësohet edhe në pullë postare. Imazhi i tij i ngritur do të udhëtojë në tërë botën dhe do ta promovojë atdheun tonë, Republikën e Kosovës. Krenaria dhe kujtimi për kampionin tonë nuk do të shuhen kurrë", ka thënë Sejdi Hoxha.

Ndërsa kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka deklaruar: "Dua të falënderoj Postën e Kosovës e cila me këtë pullë po e nderon dhe e kujton njeriun tonë dhe të mbarë Kosovës dhe më gjerë, njeriut që një jetë të tërë ia kushtoi futbollit të Kosovës dhe na la një trashëgimi të jashtëzakonshme duke na bërë pjesë të Evropës dhe botës. Sikur që gjatë jetës së tij legjenda Fadil Vokrri që shëtiti anembanë botës, tash pas vdekjes do ta shëtisë botën portreti i tij në dërgesat e Postës së Kosovës, do të përshkojë sërish botën dhe me këtë do të lartësohet edhe më shumë figura e tij".

Ndërkaq djali i Fadil Vokrrit, Gramoz Vokrri, në emër të familjes shprehu mirënjohjen për PTK-në. "Kjo na nderon gjithë familjen, por edhe të gjithë shqiptarët ku do që janë, sepse babai ishte më shumë i tyre sesa i yni", ka deklaruar Gramoz Vokrri.

# Krasniqi e Haxhijaj: Sukses i jashtëzakonshëm për të gjithë Kosovën

Prishtinë, 8 tetor - Nënpresidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Memli Krasniqi, njëherësh nënkryetar i Federatës së Xhudos së Kosovës, nga afër ka parë suksesin historik të xhudistes Erza Muminoviq. 16-vjeçarja nga Peja fitoi medaljen e bronztë në Lojërat Olimpike për të rinj, Buenos Aires 2018, të parat për Kosovën, katër vjet pas pranimit të KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. "Shpesh herë po na bie të themi për një garë historike, por kjo vërtet ishte një medalje historike, sepse Kosova për herë të parë po merr pjesë në Lojërat Olimpike për të rinj dhe përsëri në ditën e parë të garave, Erza, xhudistja jonë e shkëlqyeshme e gjeneratës së re, mori medaljen e bronztë. Është një ndjenjë e jashtëzakonshme, sepse pas pjesëmarrjes së parë në Lojërat Evropiane, ku fituam të bronztën dhe më pas në LO RIO 2016, me të artën e Majlindës, tani kemi përsëri një xhudiste që fiton medalje", ka thënë Krasniqi për faqen zyrtare të KOK-ut. Sipas tij, rezultatet e xhudos nuk janë të rastësishme. "Është një nder i madh për të gjithë qytetarët e



Kosovës të cilët po mburren me të gjithë sportistët e Kosovës dhe këta sportistë meritojnë mbështetjen që kanë, por pa dyshim meritojnë mbështetje edhe më të madhe nga ne. Më vjen mirë që si Federatë e Xhudos kemi punuar në vazhdimësi për t'iu dhënë mundësi talentëve të rinj, në bashkëpunim edhe me KOK-un e MKRS-n. Këto rezultate nuk janë të rastësishme, por bazohen në një punë të hatashme që bëhen nga këta xhudistë vetë, trajneri Driton Kuka, si dhe Fatos Tabaku me Erzën dhe të tjerë, dhe nga një pasion i madh për ta përfaqësuar Kosovën në mënyrën më të dinjitetshme, siç e kishim edhe këtë rast", ka deklaruar Krasniqi. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Shasivar Haxhijaj, ka komentuar medaljen historike të Kosovës, të fituar nga xhudistja e re, Erza Muminoviq. "Ishte një ditë e vështirë që na u shpërblye me medalje. Këtij suksesi i është gëzuar i gjithë Ekipi Olimpik i Kosovës. Fituam të bronztën, e cila është historike për ne dhe me këtë rast dua ta përgëzoj Erzën, për të cilën është një sukses i jashtëzakonshëm, si për të, ashtu edhe për Federatën e Xhudos së Kosovës, vetë Komitetin Olimpik të Kosovës dhe gjithë Kosovën. Edhe kësaj radhe nuk do të kthehemi në Kosovë pa medalje", ka deklaruar Haxhijaj.

## SHKURT

### Shtohen problemet për Ronaldon, një tjetër femër akuzon për përdhunim

Nuk kanë fund telashet për yllin e Juventusit, Cristiano Ronaldon. Një tjetër akuzë për përdhunim ndaj yllit portugez. Sipas avokatit të akuzueses së parë, Ketrin Majorgan, një tjetër femër ka akuzuar yllin portugez për përdhunim. "Kam marrë një telefonatë nga një femër që pretendon se edhe ajo është përdhunuar nga Ronaldo", tregon Stoval për "Daily Mail", ndërsa më vonë për "The Sun" ka zbuluar se edhe dy femra të tjera pretendojnë se janë përdhunuar ose ngacmuar seksualisht nga Ronaldo. Avokati ka refuzuar ta zbulonte emrin e femrës, duke treguar se do të flasë me policinë e Las Vegasit.

### Federeri: Mund të rikthehem në Tokio

Roger Federeri ka pasur gjithnjë një simpati dhe dashuri të veçantë për Lojërat Olimpike, duke marrë pjesë në katër prej tyre: Sidney 2000, Athinë 2006, Pekin 2008 dhe Londër 2012. "Nga Lojërat Olimpike, për një arsye, më pëlqen më shumë sporti i volejbollit", thotë tenisti zvicer-an. "Por unë jam një tenist dhe adhuroj sportin tim, më pëlqen të jem në Olimpiadë dhe medaljet që fitojmë aty kanë një rëndësi të veçantë. Në atë moment t'i përfaqëson më shumë se kudo vendin tënd", ka deklaruar Federeri.

Në katër edicionet ku ka marrë pjesë, Federeri ka fituar vetëm një herë të artën në lojën dyshe, së bashku me Stanislas Wawrinka, në Pekin 2008. "Ajo medalje ishte surprizë për mua. Kam fituar edhe të argjendtën në Londër, në Wimbledon dhe ishte diçka e jashtëzakonshme (u mund në finale nga Andy Murray). Në Olimpiadë kam mbajtur dy herë flamurin e Zvicrës në ceremoninë e hapjes, në Sidney kam takuar bashkëshorten time. Kam shumë kujtime, ndoshta rikthehem në Tokio", ka shtuar Federeri.

### Kloppi kundër Ligës së Kombeve

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, e ka kritikuar garën e Ligës së Kombeve, duke e quajtur si një garë të pakuptimtë. "Tani lojtarët shkojnë dhe luajnë në Ligën e Kombeve, e cila është gara më e pakuptimtë në botë. Ne duhet të mendojmë për lojtarët. Duhet ta thërrasësh trajnerin e ndonjë kombëtares dhe t'i thuash që ta lërë ndonjë lojtar jashtë dhe ai thotë se është nën presion për këtë", ka thënë Kloppi.

Liga e Kombeve e UEFA-s është turne i ri ndërkombëtar në të cilin kombet evropiane garojnë në një format lige për ta pasur mundësinë të luajnë në "Final Four" verën e vitit 2019, ku fituesi do të shpallet kampion i Ligës së Kombeve.

### Bobani: Milani do të rikthehet

Zvonimir Boban ka zbuluar se çfarë i duhet Milanit që të rikthehet në majat e futbollit. Ish-lojtari i kuqezinjve ka thënë se klubi duhet të ketë durim për t'u rikthyer. "Unë kam besim se Milani do të rikthehet shumë shpejt. Leonardo dhe pjesa tjetër e Milanit janë duke punuar shumë që të rikthehen, por unë ju them se duhet të kenë durim. Lojtarët janë duke bërë një lojë të mirë, pasi me Higuainin, gjërat do të shkojnë mirë", ka thënë Boban.

### Lopetegui, afat deri më 28 tetor

Reali i Madridit ka regjistruar 4 humbje në 11 ndeshjet e para të këtij sezoni, diçka që nuk e shihnim që nga sezoni 2005-2006. Tashmë skuadra "merengues" është në telashe të mëdha. Pas kthimit nga Vitoria në përfundim të ndeshjes me Alavesin, presidenti i Realit të Madridit dhe Jose Angel Sanchez zhvilluan një sërë bisedash telefonike dhe tema e diskutimit ishte pikërisht trajneri Julen Lopetegui.

